



Agjencia për Mbështetjen
e Shoqërisë Civile

Adresa:

Rruga "Frosina Plaku",
Nr. 58, Kati II,
Tiranë, Shqipëri

Telefon:


04 22 355 69

E-mail:


info@amshc.gov.al

Website:

www.amshc.gov.al



RAPORT I ZGJERUAR VJETOR 2020



ECURIA E REALIZIMIT BUXHETOR PËR VITIN 2020			
Struktura Buxhetore	Shpenzimet Progressive fakt	Plani Vjetor sipas ndryshimeve të bëra	Realizimi në përqindje
Llogaritë e pagave (zëri 600)	14,537,720	14,550,000	99%
Kontribute sigurime shoqërore shëndetësore (zëri 601)	2,390,420	2,400,000	99%
Shpenzime të tjera - Korrente (zëri 602)	2,668,760	4,550,000	58%
Transferat GRANTE (zëri 604/1)	59,133,000	61,000,000	96%
Investime të brendshme (zëri 231)	477,000	1,000,000	47%
Transferat Familjare dhe individët (zëri 606)	60,000	1,000,000	6%
Totali	79,266,910	83,600,000	94%



Thirrja Nr. 13*
për projekt-propozime
(22 qershor - 23 korrik 2020)

*Thirrja e kësaj lloji mund të ndryshojë në të kaluarë dhe mund të ndryshojë në të ardhme.

The CALL for proposal
(June 22nd - July 23rd 2020)

ONLINE:
www.amshc.gov.al



Agjencia për Mbështetjen
e Shoqërisë Civile

RAPORT MBI VEPRIMTARINË E AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE GJATË VITIT 2020

Tiranë, Maj 2021

Tabela e përmbajtjes:

KAPITULLI I	2
▪ <i>Vështrim i përgjithshëm</i>	<i>2</i>
▪ <i>Organet dhe funksionet e institucionit</i>	<i>3</i>
▪ <i>Kuadri ligjor, organizimi strukturor dhe funksionimi i AMShC-së.....</i>	<i>4</i>
KAPITULLI II.....	5
▪ <i>Strategjia Ndërsektorale Kundër Korrupsionit:</i>	<i>5</i>
▪ <i>Zbatimi i Ligjit "Për të Drejtën e Informimit" si dhe i Ligjit "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik"</i>	<i>6</i>
▪ <i>Analiza dhe statistika të shpërndarjes së granteve të Thirrjes 13 sipas fushave prioritarë si dhe shtrirjes territoriale.....</i>	<i>7</i>
▪ <i>Shpërndarja territoriale sipas qarqeve administrative e projekteve fituese</i>	<i>9</i>
KAPITULLI III	13
▪ <i>Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC).....</i>	<i>13</i>
KAPITULLI IV	15
▪ <i>Monitorimi/Vlerësimi i performancës së treguesve Buxhetorë për Vitin 2020</i>	<i>15</i>
▪ <i>Plani fillestar i Buxhetit Viti 2020</i>	<i>16</i>
▪ <i>Rishikimi i Buxhetit për Vitin 2020 si dhe ndryshimet e ndodhura nga plani fillestar</i>	<i>17</i>
▪ <i>Analiza e realizimit të treguesve buxhetorë për Vitin 2020</i>	<i>21</i>
KAPITULLI V	27
▪ <i>Aktivitetet kryesore të AMShC-së për vitin 2020.....</i>	<i>27</i>

KAPITULLI I

Vështrim i përgjithshëm

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, është një ent publik, buxhetor krijuar me Ligjin me nr. 10093 datë 09.03.2009 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile".

AMShC-ja është krijuar me qëllimin për të asistuar me Mbështetje Financiare dhe Teknike Shoqërinë Civile në vend duke qenë e përkushtuar të promovojë, mbështesë dhe mbrojë parimet e dinjitetit njerëzor, lirisë, barazisë, mos-diskriminimit, sundimit të ligjit, respektimin e të drejtave të njeriut, transparencës dhe profesionalizmit.

Një shoqëri civile aktive, e fuqishme dhe gjithë përfshirëse mund të luajë një rol të rëndësishëm për zbatimin në praktikë të këtyre parimeve. Ajo është gjithashtu një komponent thelbësor i çdo demokracie funksionale.

Duke artikuluar shqetësimet e qytetarëve, organizatat e shoqërisë civile, si subjekte jo- shtetërore, struktura jo-fitimprurëse, në të cilat njerëzit organizohen të ndjekin objektivat dhe idealet e përbashkëta, duhet të jenë gjithnjë e më shumë aktivë për çështje publike si dhe të angazhohen në iniciativa që nxisin pluralizmin dhe pjesëmarrjen në demokraci.

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, në kuadër të politikës së fuqizimit të shoqërisë civile, është përqendruar në stimulimin e demokracisë pjesëmarrëse dhe gjithë përfshirëse.

Kjo reflektohet në përpjekjet për krijimin e një mjedisi që është i favorshëm për aktivitetet e shoqërisë civile dhe ndërtimin e kapaciteteve të OJF-ve për të qenë aktorë të efektshëm, të përgjegjshëm dhe të pavarur, nëpërmjet formalizmit të procedurave transparente dhe jo-diskriminuese të regjistrimit, veprimtarisë së lirë dhe të pavarur, si dhe bashkëpunimit midis qytetarëve etj.

Shoqëria civile, duke pasur struktura të përshtatshme dhe mekanizma për bashkëpunim me AMShC-në dhe institucionet e tjera publike, si dhe fluks të lirë, të qartë dhe të arritshme të informacionit mbi çështjet e interesit publik përmes mekanizmave të qëndrueshme dhe të strukturuar, rrit autonominë e saj, atë të përfaqësimit dhe të llogaridhënies, duke forcuar bazën e organizatave sipas standardeve më të larta të qeverisjes së brendshme, nëpërmjet përfshirjes së strukturave demokratike, monitorimit dhe vlerësimit, menaxhimit financiar, transparencës, informimit dhe bashkëpunimit të ndërsjellë.

Organet dhe funksionet e institucionit

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile është krijuar me Ligjin nr. 10093 datë 09.03.2009 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile” dhe ka si mision të saj, nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë civile dhe krijimin e kushteve të favorshme për nisma civile, në të mirë dhe në interes të publikut.

Për përmbushjen e këtij misioni, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile ka si detyrë të saj funksionale që të ofrojë asistencë financiare dhe teknike për programet që nxisin e forcojnë qëndrueshmërinë e organizatave jofitimprurëse; bashkëpunimin ndër-sektorial e ndërkombëtar; nismat civile; filantropi; vullnetarizmin e institucioneve demokratike të shoqërisë civile; si dhe programe të tjera, që lehtësojë përmbushjen e misionit të saj.

AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- *nxitjen e bashkëpunimi me OJF-të, që kanë objekt të punës mbikëqyrjen e luftës kundër korrupsionit; luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore e të trajtimit të viktimave të saj; kundër dhunës në familje e kundër dhunës ndaj fëmijëve;*
- *nxitjen e qytetarëve në veprimtari, përfshirja e pjesëmarrja e tyre për zhvillimin e komunitetit;*
- *respektimin e të drejtave të njeriut;*
- *krijimin e konsolidimin e kapaciteteve të shoqërisë civile;*
- *zhvillimin e bashkëpunimit ndër sektorial dhe e bashkëpunimit ndërmjet organizatave të shoqërisë civile;*
- *rritjen e ndikimit publik dhe veprimtarisë së organizatave të shoqërisë civile në vendimmarrje;*
- *zhvillimin e sipërmarrjes shoqërore dhe punësimit në sektorin jofitimprurës;*
- *rritjen e ndikimit të shoqërisë civile në proceset e hartimit dhe të miratimit të politikave publike*
- *përcaktimin e procedurave të zbatueshme për shpërndarjen e fondeve në mbështetje të shoqërisë civile etj.*

Kuadri ligjor, organizimi strukturor dhe funksionimi i AMShC-së

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile funksionon dhe mbështet punën e saj duke u bazuar në një paketë të plotë ligjore, si vijon:

- a) Ligji me nr. 10093 datë 09.03.2009 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”. Ky ligj, deri më sot nuk ka pësuar asnjë ndryshim.
- b) Vendimi nr. 769 datë 15.07.2009 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statutit të Agjencisë Për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”.
- c) Vendimi nr. 789 datë 16.11.2011 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në Vendimin nr. 769 datë 15.07.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”.
- ç) Rregullorja e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, miratuar me vendimin e Bordit Mbikëqyrës në mbledhjen e datës 20.09.2010.
- d) Rregullorja e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, e azhurnuar në përputhje dhe përshtatje me ndryshimet e parashikuara në Vendimin nr. 789 datë 16.11.2011 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në Vendimin nr. 769 datë 15.07.2009 të Këshillit të Ministrave, Për miratimin e statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”. Këto ndryshime janë miratuar me vendimin e Bordit Mbikëqyrës në mbledhjen e datës 30.11.2011.
- dh) Rregullorja “Mbi procedurat e Financimit me Grante në Mbështetje të Shoqërisë Civile” të miratuar nga Bordi Mbikëqyrës me Vendimin nr. 1 datë 08.07.2010.
- e) Rregullorja “Mbi procedurat e Financimit me Grante në Mbështetje të Shoqërisë Civile”, e ndryshuar me vendimin e Bordit Mbikëqyrës në mbledhjen e datës 10.03.2011.
- ë) Vendimi nr. 1 datë 08.07.2010 i Bordit Mbikëqyrës të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, nëpërmjet të cilit janë miratuar:
 - Formati i Aplikimit.
 - Kriteret e Vlerësimit.
 - Kontrata Tip
- f) Udhëzimin nr. 1 datë 29.12.2010 i Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Për Mbështetjen e Shoqërisë Civile “Për plotësimin e raporteve financiare dhe kontrollin financiar, për efekt të monitorimit të Projekteve të financuara me Grante nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”.
- g) Urdhri nr. 161 datë 05.09.2013 i Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile “Për procedurën e administrimit të akteve shkresore, kërkesave/projekt-propozimeve, formimin e dosjeve dhe mënyra e qarkullimit të tyre në AMShC”.

KAPITULLI II

Programi Anti-Korrupsion kornizohet ligjërisht përmes akteve të miratuara nga Qeveria Shqiptare të cilat, në vetvete, sanksionojnë dhe rregullojnë veprimtarinë e Organit Qendror (AMShC-së) sipas parashikimeve të publikuara. Kjo kornizë ligjore shkon paralel me akte të tjera ligjore të cilat nuk çënojnë në zbatimin e tyre zbatimin e misionit të AMShC-së në thelb. E thënë konkretisht, ky program, është pikë zbatimi i një programi umbrellë i cili inicon dhe vijon prej Kryekoordinatorit të tij – Ministria e Drejtësisë.

Vendimi Nr. 247 datë 20.03.2015 “Për Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit për Periudhën 2015-2020” i Këshillit të Ministrave, pasqyron qartë gjëndjen në të cilën ndodhet korrupsioni dhe objektivat për realizim të kësaj strategjie të cilat do të ndihmojnë të minimizojnë këtë fenomen në të ardhmen.

Për t’i ardhur në ndihmë kësaj nisme por edhe referuar nevojave të ndryshme të adresuara në këtë prizëm, Qeveria Shqiptare, me Vendimin Nr. 241 datë 20.04.2018 “Për Miratimin e Planit të Veprimit 2018-2020, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2015-2020, e të Pasaportës së Indikatorëve, Krijimin, Funksionimin dhe Detyrat e Komitetit Koordinator për Zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2015-2020 dhe Task-Forcës Ndërinstitucionale Antikorrupsion”.

Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit:

Qëllimet madhore të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK), janë parandalimi, ndëshkimi dhe ndërgjegjësimi/edukimi rreth korrupsionit.

Kjo Strategji, përmban tri Qasje:

1. **Qasjen Parandaluese me:**
 - **11 Objektiva** të cilat zbërthehen në:
 - 21 Indikatorë dhe
 - 57 Masa
2. **Qasjen Ndëshkuese me:**
 - **4 Objektiva** të cilat zbërthehen në:
 - 9 Indikatorë dhe
 - 19 Masa
3. **Qasjen Ndërgjegjësuere me:**
 - **3 Objektiva** të cilat zbërthehen në:
 - 7 Indikatorë dhe
 - 26 Masa

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), është pjesë e Strategjisë në zbatimin e Objektivave të Qasjes Ndërgjegjësuere përmes zbatimit të programit **C3 “Qasja Ndërgjegjësuere”**.

Në vitin 2019, për realizimin e masave, AMShC realizoi:

- *Hartimin e një Programi Anti-korrupsion nga AMShC-ja;*
- *Raportimin e projekteve të anti-korrupsionit të financuar nga AMShC-ja dhe*
- *Alokimin e buxhetit në mbështetje të Projekteve të Anti-korrupsionit nga OShC-të*

Viti 2020, shënoi edhe alarmin për pandeminë globale COVID-19, çka ndikoi në reduktimin e fondeve për asistencë financiare ndaj projekteve me fokus anti-korrupsionin, duke rezultuar në një shmangie të kësaj asistence nga AMShC-ja, me tërë përpjekjet e saj për rikuperimin e situatës financiare.

Ky lloj reduktimi, sigurisht që do të jetë pjesë e raportit të Anti-Korrupsion në AMShC duke shprehur tërë përkujdesin e Institucionit për rikuperimin e situatës në vitin e ardhshëm.

Viti 2021, do të sjellë një produkt edhe më rezultativ ndaj kësaj iniciative, ku AMShC është pjesë zbatuese e saj duke synuar prodhimin e një sërë materialesh në funksion të ndërgjegjësimi mbi fenomenin e korrupsionit.

Zbatimi i Ligjit "Për të Drejtën e Informimit" si dhe i Ligjit "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik"

❖ Zbatimi i Ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" është përgatitur programi i transparencës për Agjencinë e Mbështetjes së Shoqërisë Civile.

Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së autoritetit në kuadër të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" (LDI).

Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës AMSHC ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale.

Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentin.

Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet.

Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë. Dokumentacioni i bërë publik, do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje.

Faqja zyrtare e AMSHC-së është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm.

Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve / subjekteve të të dhënave, etj.

❖ Zbatimi i Ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”

Takime informuese dhe konsultime publike me OShC-të lidhur me çështjet:*

- Në qytet: Vlorë, Korçë, Gjirokastrë, Kukës, Berat, Shkodër dhe Tiranë:
 - *Mbi procesin e përzgjedhjes së katër anëtarëve të rinj të shoqërisë civile të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile*
 - *Mbi procesin e përcaktimit të prioritetëve të Thirrjes nr. 13 për Projekt-Propozime*
- PYETËSOR ONLINE lidhur me OJF-të dhe drejtësinë e Gjykatës së Tiranës, e cila është përgjegjëse për regjistrimin e këtyre OJF-ve.
- PYETËSOR ONLINE lidhur me Udhërrëfyesin për politikën e qeverisë drejt një mjedisi më mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile.

Analiza dhe statistika të shpërndarjes së granteve të Thirrjes 13 sipas fushave prioritarë si dhe shtrirjes territoriale

AMSHC njofton shpalljen e Thirrjes 13 (të vogël)[†] 22 qershor – 23 korrik 2020.

Projekt-propozimet kanë si objekt dhe mbulojnë fusha të kësaj Thirrje të vogël, të fokusuara tek emergjenca e krijuar nga pandemia e COVID-19:

1. *Shëndetësia dhe telemjekësia (MED) si mundësi për monitorimin e pacientëve duke ju përshtatur kushteve shkaktuar nga COVID-19, në distancë si dhe ofrimin e shërbimeve të mjekësisë në familje ONLINE;*
2. *Shërbime psikosociale për situatën e post-COVID-19 për grupet në nevojë (të moshuarit, PAK, fëmijët PAK etj), përfshirë këshillim dhe terapi psikologjike, si edhe shërbime juridike, online;*
3. *Trajnime online të personelit shëndetësor lidhur me situatën e COVID-19;*
4. *Iniciativa të tjera inovative për të përmirësuar situatën e krijuar nga COVID-19;*
5. *Nxitja, stimulimi dhe fuqizimi i vullnetarizmit;*
6. *Mbështetje psikologjike, sensibilizuese dhe mjekësore nëpërmjet platformave të ndryshme*

Statistikisht shpërndarja e projekteve nën secilin prioritet strategjik paraqitet sipas Tabelës së mëposhtme:

* Në mënyrë më të detajuar i gjeni në kapitullin IV


[†] Thirrja 13 (e vogël) shpallet për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19 dhe me buxhet të reduktuar në zbatim të Aktit Normativ Nr. 6, datë 21.3.2020 “Për buxhetin e vitit 2020”.

Tabela 1

Nr.	Fushat Prioritare	Nr. Projekteve	Financimi për secilin prioritet (në lekë)	Pesha Specifike (në %)
1	Shëndetësia dhe telemjekësia (MED) si mundësi për monitorimin e pacientëve duke ju përshtatur kushteve shkaktuar nga COVID-19, në distancë si dhe ofrimin e shërbimeve të mjekësisë në familje ONLINE;	1	930,000	2.3
2	Shërbime psikosociale për situatën e post-COVID-19 për grupet në nevojë (të moshuarit, PAK, fëmijët PAK etj), përfshirë këshillim dhe terapi psikologjike, si edhe shërbime juridike, online;	5	4,760,000	11.5
3	Trajnime online të personelit shëndetësor lidhur me situatën e COVID-19;	2	1,800,000	4.4
4	Iniciativa të tjera inovative për të përmirësuar situatën e krijuar nga COVID-19;	13	10,860,000	26.3
5	Nxitja, stimulimi dhe fuqizimi i vullnetarizmit;	6	5,780,000	14.0
6	Mbështetje psikologjike, sensibilizuese dhe mjekësore nëpërmjet platformave të ndryshme	2	1,930,000	4.7
7	Projekte që prekin më shumë se një fushë prioritare	17	15,170,000	36.8
Total		46	41,230,000	100.0

Grafiku 1

Shpërndarja e Projekteve Fituese sipas peshës specifike për secilin prioritet



Siç mund të verehet nga tabela dhe grafiku, prioriteti me përqindjen më të lartë të projekteve të zbatuara është ai nën fushën 4 *“Iniciativa të tjera inovative për të përmirësuar situatën e krijuar nga COVID-19”* me një peshë specifike 26.3% që do të thotë që nën këtë prioritet projektet implementuese dhe vetë OJF-të i kanë venë theksin iniciativave të reja në kushtet e një situatë jo normale të funksionimit të jetës në vend.

Një zë tjetër i rëndësishëm i përqindjes së peshës specifike përbën dhe *“Nxitja, stimulimi dhe fuqizimi i vullnetarizmit”* me 14% të peshës specifike të projekteve të orientuara në këtë fushë prioritare.

Është e rëndësishme në rrethanat e jashtëzakonshme shqiptarët mobilizohen në vullnetarizëm, për të ndihmuar njëzëit në nevojë.

Po kështu i rëndësishëm është dhe zëri *“Shërbime psikosociale për situatën e post-COVID-19 për grupet në nevojë (të moshuarit, PAK, fëmijët PAK etj), përfshirë këshillim dhe terapi psikologjike, si edhe shërbime juridike, online”* i cili zë një përqindje të mirë të projekteve të financuara në këtë thirrje me një peshë specifike 11.5%.

Ndërkaq, kategoria më shumë se një prioritet / fushë në përgjithësi nga statistikatat ka qenë një kategori që gjithnjë ka pasur një përqindje të lartë, pasi projektet kanë qenë të një natyre më të gjerë, por që për këtë thirrje kjo kategori është në përqindje më të ulur krahasimisht me vitet e tjera. Pra projektet kanë qenë më të orientuar në një prioritet të caktuar.

Shpërndarja territoriale sipas qarqeve administrative e projekteve fituese

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në mënyrë të vazhdueshme duke qenë se në filozofinë e saj e misionin e saj ka një shpërndarje të projekteve fituese sa më të gjerë në të gjithë territorin.

Në të njëjtën përqasje edhe në thirrjen e saj Nr. 13 të drejtuar OJF-ve për shprehje interesi për Projekt Propozime e ka pasur si objekt kryesor një shpërndarje territoriale sa më të gjerë në nivel kombëtar.

Siç mund të vihet re nga të dhënat tabelave/grafikëve si dhe shpërndarjes në përqindje; por edhe asaj territoriale, Projektet fituese kanë një përqëndim më të lartë të zbatueshmërisë në rrethin e Tiranës.

Mbulimi për financim me projekte në përgjithësi prek të gjitha qarqet administrative. Mbulimin me përqindje më të lartë siç u përmend dhe më lartë e zë Qarku i Tiranës, më pas vijnë qarqet Berat, Vlorë, Gjirokastrë, Elbasan, Durrës, Korçë etj.

Në mënyrë më të detajuar për këtë shpërndarje të dhënat shprehen në tabelat dhe grafikët e mëposhtëm.

Tabela 2

Shpërndarja Territoriale e projekteve fituese për Thirrjen 13

Nr.	Shtrirja në Nivel Qarku dhe Kombëtar	Nr. i projekteve fituese
1	Qarku i Beratit	2
2	Qarku Dibër	2
3	Qarku Durrës	3
4	Qarku Elbasan	4
5	Qarku Fier	3
6	Qarku Gjirokastrë	1
7	Qarku i Korçë	4
8	Qarku Kukës	3
9	Qarku Lezhë	3
10	Qarku Shkodër	5
11	Qarku Tiranë	9
12	Qarku Vlorë	4
13	Projekte në Nivel Kombëtar	5

Grafiku 2

Shpërndarja Territoriale e projekteve fituese për Thirrjen 13





Tabela 3

Shpërndarja Territoriale e projekteve fituese për Thirrjen 13 sipas qyteteve

Nr.	Shtirirja në Nivel Qarku, Qyteti dhe Kombëtar	Nr. i projekteve fituese
1	Qarku i Beratit	2
1.1	Berat	2
1.2	Kucovë	0
1.3	Skrapar	0
2	Qarku Dibër	2
2.1	Peshkopi	2
2.2	Bulqizë	0
2.3	Mat	0
2.4	Klos	0
3	Qarku Durrës	3
3.1	Durrës	3
3.2	Krujë	0
4	Qarku Elbasan	4
4.1	Elbasan	3
4.2	Gramsh	0
4.3	Librazhd	1
4.4	Peqin	0
4.5	Prrenjas	0
4.6	Cerrik	0
5	Qarku Fier	3
5.1	Fier	2
5.2	Lushnje	1
5.3	Mallakastër	0
5.4	Roskovec	0
6	Qarku Gjirokastër	1
6.1	Gjirokastër	1
6.2	Përmet	0
6.3	Tepelenë	0
7	Qarku i Korçë	4
7.1	Korçë	3
7.2	Devoll	0
7.3	Pogradec	1
7.4	Kolonjë	0
7.5	Maliq	0
7.6	Pustec	0
8	Qarku Kukës	3
8.1	Kukës	2
8.2	Tropojë	1
8.3	Has	0
9	Qarku Lezhë	3
9.1	Lezhë	2
9.2	Kurbini	1
9.3	Mirditë	0
10	Qarku Shkodër	5

10.1	Shkodër	5
10.2	Pukë	0
10.3	Malësi e Madhe	0
10.4	Vau i Dejës	0
10.5	Fush-Arrëz	0
11	Qarku Tiranë	9
11.1	Tiranë	9
11.2	Kamëz	0
11.2	Kavajë	0
11.4	Vorë	0
12	Qarku Vlorë	4
12.1	Vlorë	4
12.2	Sarandë	0
12.2	Delvinë	0
12.4	Selenicë	0
12.5	Himarë	0
12.6	Finiq	0
12.7	Konispol	0
13	Projekte në Nivel Kombëtar	5

Grafiku 3
Shpërndarja Territoriale e projekteve fituese për Thirrjen 13 sipas qyteteve



KAPITULLI III

Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC)

Referuar nevojave dhe synimit për përafrimin e legjislacionit por jo vetëm, edhe strukturave shtetërore për funksionim edhe më të saktë të shoqërisë civile, Qeveria Shqiptare ndërmorri iniciativën për themelimin dhe organizimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile.

Misioni themelor i këtij Këshilli do të jetë garantimi i bashkëpunimit institucional me organizatat e shoqërisë civile në dobi dhe në funksion të zgjerimit të demokracisë.



Në vazhden e kësaj nisme, Qeveria Shqiptare, në fundvitin e 2015-ës, miratoi Ligjin Nr. 119/2015 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile”.

Përgjatë vitit 2020, Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC):

- Më datë 5 qershor 2020, anëtarë dhe ish anëtarë përfaqësues nga organizata të shoqërisë civile në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC) i drejtuan Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Komitetit Teknik të Ekspertëve (për masat Anti COVID-19) një letër të hapur, ku kërkonin fillimin e lejimit të aktiviteteve të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC).
- Më datë 10 qershor 2020, organizata përfaqësuese nga shoqëria civile në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile dhe rrjeti i organizatave i drejtuan Qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, Partive politike në Shqipëri dhe Partnerëve ndërkombëtarë një letër të hapur për një sistem zgjedhor, i cili të përfaqësojë më të mirën për qytetarët shqiptarë.
- Më datë 2 korrik 2020, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) në kuadër të konsultimit publik të draftit të Projektligjit “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”, i cili synon minimizim e procesit të regjistrimit të OJF-ve por edhe sigurimin e transparencës lidhur me funksionimin e tyre, organizoi mbajtjen e një takimi online me anëtarë përfaqësues të shoqërisë civile në KKShC, ditën e enjte, datë 2.7.2020, ora 10:30 nëpërmjet platformës / aplikacionit ZOOM.
- Më datë 21 korrik 2020, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) në rolin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC) në kuadër të konsultimit publik të draftit të Projektligjit “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”, organizoi mbajtjen e mbledhjes online të KKShC-së, ditën e martë, datë 21.7.2020, ora 15:00 nëpërmjet platformës / aplikacionit ZOOM.

Mbledhja u drejtua nga Kryetarja e KKShC-së, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, znj. Ogerta Manastirliu. Në fillim të fjalës së saj, znj. Manastirliu falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen si dhe në emër të Këshillit shprehu ngushëllimet e singerta për humbjen e parakohshme të jetës së anëtarit të shoqërisë civile pranë Këshillit, z. Ali Coka.

Në vijim të agjendës së mbledhjes u zhvillua prezantimi i projektligjit për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse nga z. Besmir Beja si dhe diskutime me të pranishmit për këtë projektligj.

- Në mbështetje të Ligjit Nr. 119/ 2015 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile” dhe Rregullores mbi Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC), organizoi procesin e zgjedhjeve për katër anëtarë nga Shoqëria Civile, vakanca të krijuara për shkak të përfundimit të mandateve 2-vjeçare. Ky proces përfundoi me sukses duke shpallur më datë 8 shtator 2020 emrat e katër anëtarëve të rinj të zgjedhur nga procesi i votimit *online*:

- **Për fushën e veprimit A.**

“Demokratizimi, sundimi i ligjit, të drejtat e njeriut dhe integrimi në BE”

- 1. **Dritan Sakuta**

Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim (RIAS)

- 2. **Armando Bala**

Vizioni i Ri 2016 / New Vision Organization

- **Për fushën e veprimit B.**

“Zhvillimi ekonomiko-territorialo-mjedisor”

- 1. **Ermelinda Mahmutaj**

Qendra Mjedisore për Zhvillim, Edukim dhe Rrjetëzim (EDEN)

- **Për fushën e veprimit C.**

“Përmirësimi i mirëqenies, shërbimeve sociale, mbrojtjes së shëndetit si dhe cilësisë së jetës”

- 1. **Andi Rabiaj**

Rrjeti i Organizatave “Zëri i të Rinjve”

- Më datë 26 nëntor 2020, mbahet mbledhja e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC), e cila u organizua *online* nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) nëpërmjet platformës / aplikacionit ZOOM.

Mbledhja u drejtua nga Zëvendësministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, z. Albert Nikolla.

Gjatë mbledhjes u prezantuan katër anëtarët e rinj të zgjedhur nga shoqëria civile si dhe u vijua me prezantimin për konsultimin e Planit të Veprimit të Open Government Partnership (OGP); prezantimin për mbështetjen e zbatimit të Udhërrëfyesit (Road Map) të Shoqërisë Civile; etj.

KAPITULLI IV

Hyrje

Në mbështetje të nenit 104 pika 4 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 65 të Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 *“Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”* (të ndryshuar), të Ligjit Nr.88/2019 *“Për Buxhetin e Vitit 2020”*, në zbatim të Udhëzimit të përhershëm të Ministrit të Financave Nr.2, datë 6.02.2012 *“Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”*, në zbatim të Udhëzimit plotësues nr. 2, datë 20.01.2020 *“Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”* si edhe sipas Udhëzimit nr.22 datë 17.11.2016 *“Për Procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore”*, Institucioni Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, raporton mbi treguesit e buxhetit për vitin 2020.

Monitorimi/Vlerësimi i performancës së treguesve Buxhetore për Vitin 2020

Siç edhe dihet, Monitorimi në këtë rast është një proces vlerësimi performance i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuara. Pra, monitorimi është procesi që lidh realizimin e objektivave dhe produkteve me fondet përkatëse të planifikuara për arritjen e tyre.

Me anë të këtij relacioni/raporti monitorimi të Buxhetit të AMSHC - së për Vitin 2020 saktësojmë informacionin mbi efektivitetin e përdorimit të fondeve buxhetore dhe performancën e produkteve të realizuara për Vitin 2020 përse i përket **Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile**.

Në përdorimin e fondeve buxhetore, AMSHC-ja është mbështetur në parimet e menaxhimit dhe mirëfunksionimit të sistemit buxhetor. Këtë vit duhet shtuar se disa nga shpenzimet janë lidhur edhe me përshtatjen me kushtet e reja me prezencën e pandemisë botërore të Covid-19, por edhe respektimit të masave anti-covid që lidhen kryesisht me distancimin social, me punën online nga shtëpia dhe prezencën me grafik nëpër zyra etj. sipas protokollit të Administratës Publike për masat anti-covid dhe instruksioneve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale.

Shpërndarja e burimeve financiare është bërë në përputhje me politikat ekonomike dhe prioritetet e AMSHC-së, duke pasur si synim një përdorim sa më eficient të këtyre burimeve, përgjegjësi të qarta për menaxhimin e shpenzimeve për çdo produkt, në funksion të realizimit të objektivave dhe aktiviteteve të përcaktuara nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile për vitin 2020.


Plani fillestar i Buxhetit Viti 2020

Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, në mbështetje të Ligjit Nr.88/2019 “Për Buxhetin e Vitit 2020”, në zbatim të Udhëzimit të përhershëm të Ministrit të Financave Nr.2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, në zbatim të Udhëzimit plotësues nr. 2, datë 20.01.2020 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020, i është akorduar një fond i planifikuar prej **123,500,000 lekë**, i detajuar në tabelën e mëposhtme nga:

Tabela 4
Plani fillestar i Buxhetit – Viti 2020

Fondi i Pagave	(zëri 600)	13,800,000	Lekë
Fondi i Sigurimeve Shoqërore	(zëri 601)	2,700,000	Lekë
Fondi për Shpenzime Operative	(zëri 602)	5,000,000	Lekë
Fondi për transfertat ndaj të tretëve	(zëri 604)	101,000,000	Lekë
Fondi për Investimet e Trupëzuara	(zëri 231)	1,000,000	Lekë
TOTAL		123,500,000	Lekë

Grafiku 4
Plani fillestar i Buxhetit – Viti 2020 (në lekë)



Duke vlerësuar konstatimet dhe sugjerimet e Ministrisë së Financave përsa i përket Përgatitjes së Fazës së Parë të PBA-së 2021-2023, vlerësojmë se Ekipi i Menaxhimit të Programit gjatë vitit 2020, ka bërë një punë të mirë dhe të përgjegjshme në drejtim të respektimit të përcaktimeve të udhëzimit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm përshtatur specifikisht për natyrën e detyrave dhe përgjegjësi që AMSHC mbulon në bazë të Ligjit mbi të cilin është krijuar dhe funksionon prej shumë vitesh tashmë.

Gjithashtu, vlen të theksohet se këtë vit, përgatitja e PBA-së është bërë në sistemin AFMIS në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Financave dhe kujdesin e tyre, por vlerësohet se akoma ka punë në perfeksionimin e këtij sistemi dhe punës me këtë sistem online i cili në të ardhmen pritet të facilitojë dhe unifikojë punën e Institucioneve për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm.

- Së pari, në kuadër të pikës 3 të Udhëzimit nr.10, dt.28.02.2017 *“Përfshirja e shoqërisë Civile në përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm”*, ju vemë në dijeni se pjese e planeve të punës në baza vjetore për AMSHC- në, është gjithmone realizimi i takimeve konsultative me përfaqësues të Shoqërisë Civile në Shqipëri me qëllim njohjen me problematikat e hasura, me sugjerimet e tyre lidhur me organizimin e punës në Institucion, sugjerimet e tyre përsa i përket detajimit të zërave buxhetore si dhe përsa i përket aktiviteteve që janë të rëndësishme për t’u organizuar me qëllim përcjelljen e “feedback” të qartë të OJF-ve në punën tonë të përditshme si Institucion që mbështet fuqizimin e një Shoqërie Civile të qënësishme në vend.
- Së dyti, në vijim të punës për të realizuar me sukses buxhetimin gjinor edhe AMSHC-ja ka përcaktuar produkte/objektiva/aktivitete/kosto të detajuara për arritjen e barazisë gjinore si dhe ka financuar dhe ndjekur projekte me këtë qëllim.

Rishikimi i Buxhetit për Vitin 2020 si dhe ndryshimet e ndodhura nga plani fillestar

Gjatë vitit buxhetor 2020 Buxheti akorduar AMSHC-së, ka pësuar disa ndryshime nëpërmjet akteve normative apo edhe kërkesave për rialokim fondi për nevojat e AMSHC-së të cilat do të pasqyrohen më poshtë:

1. Së pari, nëpërmjet Aktit Normativ Nr.15, datë 15.04.2020 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, në zbatim të udhëzimit të Ministrit të Financave nr.9, dt.20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, pakësimet për Agjencinë për Mbeshtetje të Shoqërisë Civile qenë sipas tabelës poshtëshënuar:*

Tabela 5

Tabela e pakësimeve në zbatim të Aktit Normativ nr. 15 dt. 15.04.2020
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Tab në 000 leke

Enti i Qeverisjes	Ministria e Linjës	Kod Institucionit	Emri i Institucionit	Kapitulli	Programi	Llogaria Ekonomike	Deges se Thesarit	Kod Projektit	Emertimi i projektit	Debit
			Pakesohet							
01	88	1088001	Agjencia per Mbeshtetjen e Shoqerise Civile	1	1110	604	3535			40,000
TOTAL										40,000

Pra një reduktim në llogarinë e granteve me 40,000,000 lekë për arsye të foksusit të Qeverisë Shqiptare në luftën kundër pandemisë globale Covid-19.

2. Riallokimi i fondit të llogarise 606 nga fondi i veçantë nëpërmjet shkresës së Agjencisë për Mbështetje të Shoqërisë Civile nr.138 Prot, datë 12.05.2020 me subjekt “Kërkesë për miratim të përdorimit të fondit të veçantë për rast fatkeqësie” fond i cili është përdorur nga Institucioni në zbatim të pikave 52-58, të Udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.2 datë 20.01.2020 si edhe sipas ne bazë të vendimit nr.929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”.

Ndryshimi në plan buxhetin fillestar të AMSHC, në këtë rast ishte shtim në llog 606 me vlerë 100,000 lekë dhe shpenzimi faktik për këtë llogari është në vlerën 60,000 lekë.

3. Ndryshimi tjetër që ndodhi në plan-buxhetin e AMSHC-së përgjatë vitit 2020 ishte për llogari të pagave të stafit si më poshtë detajuar sipas llogarive:

Tabela 6

Riallokim fondi për llogarinë e pagave/ sigurimeve – Viti 2020 (tabela në 000 lekë)

Ent.Qeverisje	Min Linjes	Kod Institucioni	Emer Institucion	Kapitulli	Programi	Llog.Ekonomike	Kod Thesari	Shuma
SHTOHET								
01	88	1088001	AMSHC	01	01110	600	3535	750,000
PAKESOHET								
01	81	1088001	AMSHC	01	01110	602	3535	450,000
01	81	1088001	AMSHC	01	01110	601	3535	300,000

Pas këtyre ndryshimeve ndodhur gjatë vitit 2020 në buxhet, plani i buxhetit përfundimtar për AMSHC-në është si më poshtë vijon:


Tabela 7

Plani i Buxhetit përfundimtar për AMSHC-në – Viti 2020

Fondi i Pagave	(zëri 600)	14,550,000	Lekë
Fondi i Sigurimeve Shoqërore	(zëri 601)	2,400,000	Lekë
Fondi për Shpenzime Operative	(zëri 602)	4,550,000	Lekë
Fondi për transfertat ndaj të tretëve	(zëri 604)	61,000,000	Lekë
Fondi për Transferta Familjare dhe Individët	(zëri 606)	100,000	Lekë
Fondi për Investimet e Trupëzuara	(zëri 231)	1,000,000	Lekë
TOTAL		83,600,000	Lekë

Grafiku 5

Plani i Buxhetit përfundimtar për AMShC-në – Viti 2020 (në lekë)



❖ Programi “Mbështetje për Shoqërinë Civile”


Grafiku 6

Ecuria e realizimit buxhetor për vitin 2020 (në lekë)

ECURIA E REALIZIMIT BUXHETOR PËR VITIN 2020			
Struktura Buxhetore	Shpenzimet Progressive Fakt	Plani Vjetor sipas ndryshimeve të bëra gjatë vitit	Realizimi në përqindje
<i>Llogaria e pagave</i> (zëri 600)	14,537,720	14,550,000	99 %
<i>Kontribute sigurime shoqërore shëndetësore</i> (zëri 601)	2,390,420	2,400,000	99 %
<i>Shpenzime të tjera Korrente</i> (zëri 602)	2,668,760	4,550,000	58 %
<i>Tranferta GRANTE</i> (zëri 604/1)	59,133,000	61,000,000	96 %
<i>Investime të brendshme</i> (zëri 231)	477,000	1,000,000	47 %
<i>Transferta Familjare dhe Individët</i> (zëri 606)	60,000	1,000,000	60 %
Totali	79,266,910	83,600,000	94 %


Grafiku 7

Ecuria e realizimit buxhetor për vitin 2020 (në lekë)



Grafiku 8

Ecuria e realizimit buxhetor për vitin 2020 (në përqindje)



Analiza e realizimit të treguesve buxhetorë për Vitin 2020

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore (zëri 600-601), është realizuar në zbatim të Strukturës Organizative të miratuar me Vendim nr. 769 datë 15.07.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Statutit të Agjencisë Për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”. Ndryshuar me Vendimin nr. 789 datë 16.11.2011 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në Vendimin nr. 769 datë 15.07.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, të Ligjit Nr.88/2019 “Për Buxhetin e Vitit 2020”, në zbatim të Udhëzimit të përhershëm të Ministrit të Financave Nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, në zbatim të Udhëzimit plotësues nr. 2, datë 20.01.2020 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, gjithashtu në zbatim të Vendimit Nr. 47, datë 22.1.2020 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2020, në njësitë e qeverisjes qendrore”.

Nga fondi i përgjithshëm i pagave dhe shpërblimeve, si dhe i sigurimeve shoqërore, gjatë këtij viti, është realizuar respektivisht:

- **14,537,720 Lekë** (zëri 600) për paga, realizimi **99%**
- **2,390,420 Lekë** (zëri 601) për kontribute për sigurimet shoqërore shëndetësore, realizimi **99%**
- Shpenzimet e Personelit janë realizuar në vlerën **16,928,140 Lekë** në total, që do të thotë që është një realizim shumë i mirë i fondit të pagave dhe sigurimeve për Vitin 2020

Fondi për shpenzime të tjera korrente (zëri 602), për vitin 2020, është planifikuar fillimisht me Ligjin e Buxhetit të Vitit 2020 në vlerën **5,000,000 Lekë**. Pas ndryshimeve ky zë u reduktua në **4,550,000 Lekë**

AMSHC-ja ka përmbushur detyrat e saj si Sekretariat i Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile duke mbuluar aktivitetet e KKSHC-së si edhe ka siguruar facilitetet logjistike për organizimin e mbledhjeve të KKSHC-së.

Ofrimi i asistencës ligjore në finalizimin e Udhërrëfyesit për Shoqërinë Civile ku AMSHC ndërmori një rol të rëndësishëm në hartimin dhe mirëpërcaktimin e planit të punës dhe më gjerë. Për këtë funksion, AMSHC gjithashtu ndërmori një sërë masash me qëllim realizimin sa më të saktë të tij duke përthithur produktin final (miratimin e Udhërrëfyesit). Në kuadër të zbatimit të këtij Udhërrëfyesi të rishikuar, janë specifikuar detyrat për çdo Institucion dhe aktorë të Shoqërisë Civile të përfshirë. AMSHC-ja së bashku me Kryeministrinë ka edhe detyren e rëndësishme të monitorimit të zbatimit të Udhërrëfyesit për një mjedis mundësues të Shoqërisë Civile si mekanizmi dhe plani kryesor i punës për lehtësuari dhe mundësimin e aktivitetit të OJF-ve në vend.

Roli aktiv i AMSHC-së në Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit është një tjetër arritje e Institucionit duke ndikuar sadopak në plotësimin e masave dhe indikatorëve sa i përket Qasjes Ndërgjegjësuere. Për këtë qëllim, AMSHC ka tashmë programin e saj Institucional kundër Korrupsionit, një buxhet të dedikuar për projektet anti-korrupsion. Në zërin buxhetor të AMSHC-së, disa shpenzime janë dedikuar edhe kësaj strategjie.

Edhe për këtë zë, për gjatë vitit 2020 është realizuar vlera prej **2,668,760 Lekë** ose **58%** e planit vjetor të rishikuar për AMSHC-në, disa shpenzime të planifikuara ose evente të KKSHC-së nuk u realizuan, gjithashtu lëvizjet brenda territorit në muajt e fundit të Vitit 2020 u ndërprejnë me urdhër të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si masa anti-covid.

Një arsye tjetër për këtë rezultat të shpenzimeve të zërit shpenzime, mirëmbajtje llogaria 602 janë edhe procedurat e prokurimeve online ku është synuar gjithmonë për çmimin më të ulët për blerjet në kuadër të logjistikës së përgjithshme për ecurinë normale të punës në Institucion. Ndërkohë, jo të gjitha prokurimet për Vitin 2020 janë realizuar, kjo për arsye të punës me grafik për punonjësit për shkak të pandemisë.

Në realizimin e shpenzimeve operative, AMSHC-ja është mbështetur në parimin e një shpërndarje sa më racionale të kërkesave për ecurinë optimale të veprimtarisë së Institucionit si dhe ka zbatuar *“Rregjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike”* për blerje dhe shërbime të cilat kryesisht lidhen me:

- Realizimin e shpenzimeve, të detyrueshme ndaj shtetit, si detyrime taksa e tatime, energji elektrike, ujë, shërbime postare e telefonike, në funksion të një veprimtarie normale institucionale
- Kyerjen e të gjitha blerjeve për nevoja të AMSHC-së, publikime, blerje kancelarike, riparime automjeti, lyerje dhe mirëmbajtje, pastrim etj.
- Kryerjen e pagesave për likuidimin e detyrimeve furnitorë dhe të tretë etj.
- Kryerjen e monitorimeve në terren të projekteve që AMSHC ka financuar gjatë vitit 2020

Fondi në zërin për Transferime Korrente të Brendshme (zëri 604), për vitin 2020 është planifikuar në vlerën **101,000,000 Lekë**, fillimisht por me Aktin normativ nr.15, dt.15.04.2020, u reduktua në **61,000,000 Lekë** në total.

Ky është dhe zëri më me peshë në strukturën e buxhetit të AMSHC-së, duke qene se dhe vetë misioni i këtij Institucioni ka si qëllim kryesor financimin e Shoqërisë Civile me Grante për projektpropozimet e OJF-ve përfituese.

Edhe për këtë zë, aktualisht 604 Kapitulli 1 për periudhën respektive është realizuar vlera prej **59,133,000 Lekë** ose **97%** e planit vjetor. Ndërkohë disbursimet e zërit të Granteve kanë përfshirë disbursime nga Thirrja Nr.12, Thirrja Nr.13 projektet e së cilës janë në proces monitorim/vlerësim nga ana e dy sektorëve të AMSHC-së që mbulojnë këtë detyrë të AMSHC-së. Një pjesë e disbursimeve për këtë thirrje pritet të realizohen përgjatë Vitit 2021.

Fondi për shpenzim investime (zëri 231), **1,000,000 Lekë** për Investime të Trupëzuara.

Gjatë tre mujorit të katërt të vitit 2020, janë finalizuar edhe praktikrat e prokurimit dhe ndjekjes përse i përket fondit të investimeve. Në total për këtë zë janë disbursuar **477,000 Lekë** që përbëjnë **47%** të fondit të Investimeve.

Pjesa e parealizuar e fondit të Investimeve arsyetohet me ndjekjen e procedurave online të Prokurimeve publike dhe lidhjes së kontratave me çmimin më të ulët. Investimet këtë vit kanë shkuar për përmirësimin e rrjetit të IT-së në Institucion, për përmirësimin e gjendjes së ambienteve të brendshme të zyrave etj.

AMSHC është një Institucion qendror buxhetor i krijuar me Ligjin Nr. 10093 Date 09.03.2009 *“Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”* dhe VKM Nr. 769 datë 15.07.2009 *“Per Miratimin e Statutit të AMSHC-se” (I ndryshuar)*, me mision themelor *“Nxitjen e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Shoqërisë Civile”*, si dhe *“Krijimin e kushteve të favorshme për nisma civile”*, në të mirë dhe në interes të publikut.

Për realizimin e misionit, AMSHC-ja ofron *“asistencë financiare”* për programet, që nxisin e forcojnë qëndrueshmërinë e organizatave jofitimprurëse, bashkëpunimin ndërsektorial e ndërkombëtar, nismat civile, filantropinë, vullnetarizmin e institucionet demokratike të shoqërisë,

si dhe programe të tjera si trajnime/workshops/konferenca/takime rajonale që lehtësojnë përmbushjen e misionit të saj.

Duke filluar **nga muaji Nëntor 2010 e deri në fund të vitit 2020** Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile udhëhequr nga Bordi Mbikqyrës i AMSHC-së, ka organizuar 13 Thirrje për ProjektPropozime sipas prioriteteve dhe fushave, të cilat janë objektiva të përhershëm të Institucionit, dhe janë kryer procedurat e duhura konform Ligjeve në fuqi në lidhje me njoftimin, shpalljen, vlerësimin, seleksionimin dhe kontraktimin e Organizatave Jofitimprurese për financimin me Grante të projekteve që kanë rezultuar fituese.

Më tej puna konkrete e AMSHC-së si Institucion, mbetet ndjekja e Projekteve deri në fazën finale të realizimit të tyre, Monitorimi dhe Vlerësimi i ecurisë së realizimit të Aktiviteteve konform projektpropozimit dhe kontratës së lidhur mes palëve si dhe Monitorimi dhe Vlerësimi i ecurisë së realizimit financiar të Projekteve të financuara nga AMSHC-ja dhe përputhshmëria me buxhetin e parashikuar si dhe me legjislacioni fiskal dhe tatimor të Republikës së Shqipërisë.

Sasia e granteve dhe Organizatave Jofitimprurese (shkurt OJF) të kontraktuara për t'u financuar për secilën Thirrje të organizuar nga AMSHC paraqitet si vijon:

Tabela 8

Thirrja	Numri i OJF-ve Përfituese	Vlerë e Granteve financiare (në Lekë)
Thirrje Nr. 1	52	125,918,000
Thirrje Nr. 2	31	16,000,000
Thirrje Nr. 3	69	131,960,000
Thirrje Nr. 4	63	62,105,000
Thirrje Nr. 5	47	55,200,000
Thirrje Nr. 6	21	43,755,840
Thirrje Nr. 7	41	73,500,000
Thirrje Nr. 8	18	36,000,000
Thirrje Nr. 9	41	85,200,000
Thirrje Nr. 10	35	95,100,000
Thirrje Nr. 11	45	107,700,000
Thirrja Nr. 12	52	115,600,000
Thirrja Nr. 13	46	41,230,000
TOTAL	515	989,268,840

Puna kryesore e AMSHC-së për Vitin 2020 është përqendruar në realizimin me sukses të Thirrjeve për ProjektPropozime si dhe ndjekjes/Monitorimit/Vlerësimit të projekteve të zbatuara në kuadër të këtyre Thirrjeve.

Fushat prioritare të shpërndarjes së fondeve për Vitin 2020 për Thirrjen për Projektpropozime paraqiten si më poshtë vijon:

- **THIRRJA NR. 11 (11 JANAR - 12 SHKURT 2018)**

Fushat prioritare:

1. ***Kujdesi ndaj mjedisit dhe ambientit, duke promovuar nisma ndërgjegjëse dhe aksione të tjera në drejtimin e mirëmbajtjes ambientale dhe territoriale dhe prioritetet e tjera:***
2. *Fuqizimi i kapaciteteve rinore në fushën e vullnetarizmit, trajnimeve, sipërmarrjes sociale, turizmit dhe arsimit gjithëpërfshirës dhe të vazhdueshëm si dhe protagonizmit në krijimin e organizatave të shoqërisë civile;*
3. *Mbështetje për shtresat në nevojë dhe grupet e marginalizuara të shoqërisë (jetimët, personat me aftësi të kufizuar, minoritete, LGBTI, etj) nëpërmjet fuqizimit të kapaciteteve të tyre dhe aksioneve të përfshirjes komunitare;*
4. *Fuqizimi i shtetit të së drejtës, nëpërmjet mbështetjes së iniciativave që kanë në fokus luftën ndaj korrupsionit, qytetarinë aktive, rritjen e pjesëmarrjes qytetare në vendimarrjet lokale dhe qendrore si dhe advokacinë për nisma ligjore;*
5. *Turizmi dhe kultura, si një binom zhvillimi për territorin e Shqipërisë, nëpërmjet iniciativave që kanë si qëllim rritjen e përdorimit të resurseve turistike dhe kulturore, të ndërthurura me protagonizmin rinor dhe atë të shoqërisë civile*

- **THIRRJA NR. 12 (28 SHKURT - 1 PRILL 2019)**

Fushat prioritare:

1. ***Rinia - Investim dhe garanci për të ardhmen evropiane të vendit***
 - *Fuqizimi i kapaciteteve për sipërmarrje në fusha të ndryshme zhvillimit (promovimi i produkteve vendase, zhvillimi i turizmit rural dhe urban, historike, kulturore, etnografike, folklorike, etj.)*
 - *Aktivizimi i grupeve studentore të ekselencës në programe të studimeve shkencore, inovative etj.*
 - *Rinia në tregun e vlerave (art, kulturë, inovacion etj.), ura bashkëpunimi mes gjeneratave Rinia dhe Moshë e tretë (shkëmbim eksperiencash, diskutime miqësore, histori nga e kaluara etj.)*
 - *Rinia në fokusin gjithëpërfshirës në garantimin e zhvillimit të qëndrueshëm*

- *Tryeza sensibilizimi dhe diskutimi, nisma për zhvillimin e aktivizmit dhe vullnetarizmit, pjesëmarrjes, sipërmarrjes, partneritet, arsimit, aftësimet profesional etj.*

2. Integrimi - Shoqëria civile si faktor, aktor dhe partner i rëndësishëm në proceset e integrimit evropian dhe rajonal të vendit

- *Sensibilizim, fuqizim kapacitetesh për një mjedis mundësues në proceset integruese*
- *Integrimi evropian, integrimi ekonomik rajonal (ballkanik etj.), njohja e standardeve demokratike, diskutimi, debati, dialogu, mendimi ndryshe dhe aftësia për të dëgjuar; zhvillimi i ideve dhe nismave rajonale etj.*
- *Mirëqeverisja (Pushteti Qendror dhe Lokal), transparenca, llogaridhënia, lufta kundër korrupsionit, përgjegjshmëria dhe integriteti, reforma në drejtësi, rritje kapacitetesh, inovacion, monitorim, partneritet etj.*
- *Fuqizim kapacitetesh në ideim, shkrim, zbatim, monitorim dhe raportim të projekteve për shoqatat rinore, rurale, të sapokrijuara; aplikimi i metodës LEADER etj.*
- *Edukim qytetar në funksion të proceseve integruese (familja, shkolla, komuniteti, biznesi, institucionet shtetërore etj.)*

3. Zhvillimi Social, shërbimet sociale

- *Partneritet me grupet në nevojë në fuqizim kapacitetesh etj.*
- *Mbështetje për grupet në nevojë (persona të dhunuar; grupe të traumatizuara; fëmijët e braktisur; të ngujuarit; etj.), parandalimi i konfliktit dhe dhunës; asistencë psikologjike; zgjidhje paqësore e konflikteve, mbrojtja nga sëmundjet seksualisht të transmetueshme etj.*
- *Fuqizimi/Diversifikimi i shërbime sociale për grupet në nevojë në garantimin e të drejtave të njeriut, në të gjithë spektrin e jetës politike, ekonomike, kulturore, sociale etj.*

4. Mjedis, Turizmi dhe Zhvillimi i qëndrueshëm

- *Mbrojtja dhe rehabilitimi i mjedisit; fuqizim i kapaciteteve për parandalimin dhe menaxhimin e situatave të emergjencave natyrore (përmbytjet, zjarret, tërmete etj.)*
- *Aktivizmi dhe vullnetarizmi, faktorë të rëndësishëm në mbrojtjen e një mjedisi të shëndetshëm dhe konkurrues i zhvillimit të qëndrueshëm*
- *Promovimi dhe ruajtja e vlerave historike, etnografike, turistike, artistike, kulturore, guidat turistike, koleksionistët, tolerancës fetare etj. si vlera historike e kombit shqiptar dhe detyrim ndaj brezave të ardhshëm*

- **THIRRJE NR. 13 (e vogël)[‡]** (22 QERSHOR – 23 KORRIK 2020)

Fushat prioritare, të fokusuara tek emergjenca e krijuar nga pandemia e COVID-19:

1. *Shëndetësia dhe telemjekësia (MED) si mundësi për monitorimin e pacientëve duke ju përshtatur kushteve shkaktuar nga COVID-19, në distancë si dhe ofrimin e shërbimeve të mjekësisë në familje ONLINE;*
2. *Shërbime psikosociale për situatën e post-COVID-19 për grupet në nevojë (të moshuarit, PAK, fëmijët PAK etj), përfshirë këshillim dhe terapi psikologjike, si edhe shërbime juridike, online;*
3. *Trajnime online të personelit shëndetësor lidhur me situatën e COVID-19;*
4. *Iniciativa të tjera inovative për të përmirësuar situatën e krijuar nga COVID-19;*
5. *Nxitja, stimulimi dhe fuqizimi i vullnetarizmit;*
6. *Mbështetje psikologjike, sensibilizuese dhe mjekësore nëpërmjet platformave të ndryshim*

[‡] Thirrja 13 (e vogël) shpallet për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19 dhe me buxhet të reduktuar në zbatim të Aktit Normativ Nr. 6, datë 21.3.2020 “Për buxhetin e vitit 2020”

KAPITULLI V

Aktivitetet kryesore të AMShC-së për vitin 2020

Qendra ALTERUM, tryezë e rrumbullakët mbi të drejtat e të miturve

Tiranë, 18 janar 2020



Përfaqësuesi i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), z. Ferhat Aga, mori pjesë në tryezën e rrumbullakët “Të drejtat e të miturve në konflikt me ligjin dhe trajtimi i tyre në mënyrë të barabartë gjatë vazhimit të procesit mësimor” organizuar nga Qendra ALTERUM, në kuadër të projektit “Mbrotja dhe garantimi procedural i të drejtave dhe rishoqërimin, riintegrimin dhe rehabilitimin të të miturve / të rinjve në konflikt me ligjin”.

Projekti i mbështetur financiarisht nga AMShC dhe veçanërisht, aktiviteti i datës 18 janar 2020, fokusohet në ndarjen e gjetjeve të studimit dhe organizimit të një diskutimi lidhur me problematikat dhe rekomandimet e ndërmarra me qëllim përmirësimin e situatës së të miturve në konflikt me ligjin.

Të pranishëm të tjerë në event ishte znj. Valbona Treska – Presidente e Urdhrit të Psikologut, e cila mbajti edhe fjalë përshëndetëse duke inkurajuar të pranishmit lidhur me rritjen e sensibilizimit të tyre mbi të drejtat e të miturve në procesin gjyqësor.

Z. Klodjan Skenderaj – Asoc. Prof. Dr. – ekspert pranë Qendrës ALTERUM, ndau me të pranishmit pozitën procedurale të të miturit gjatë procesit penal sikurse znj. Arbësa Kurti – Msc. Av. – eksperte pranë Qendrës ndau gjetjet dhe të dhënat statistikore lidhur me nivelin e kriminalitetit të të miturve gjatë periudhës 2018 – 2019.



NIS PROCESI I KONSULTIMIT PUBLIK ONLINE ME OSHC-të mbi përcaktimin e prioriteteve të Thirrjes nr. 13

28 janar – 20 shkurt 2020



KONSULTIM PUBLIK
me organizata të shoqërisë civile
mbi përcaktimin e prioriteteve të Thirrjes nr. 13

ONLINE: www.amshc.gov.al

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), në kuadër të realizimit të misionit të saj dhe në funksion të ofrimit të asistencës financiare për organizatat e shoqërisë civile, nis procesin e konsultimit publik me palët e interesuara lidhur me përcaktimin e prioriteteve të Thirrjes së radhës.

Në këtë kuadër, ftohen përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile të dërgojnë Sugjerimet / Komentet / Vërejtjet e tyre me qëllim për t’ju ardhur sa më në ndihmë organizatave dhe projekteve që synohen të arrihen.

Komentet dhe sugjerimet, mund t'i dërgoni nga data 28 janar – 20 shkurt 2020, me e-mail në adresën: info@amshc.gov.al ose në linkun: <http://www.amshc.gov.al/web/prioritetet.php>

Theksojmë se, një pjesë e posaçme e fondit do të kanalizohet në projekt-propozimet në funksion të prioritetit strategjik qeveritar në Luftën kundër Korrupsionit në vend.

Për këtë qëllim, AMShC-ja, në vijim do t'ju njoftojë për organizimin e takimeve konsultative në kuadër të përcaktimit dhe saktësimit të prioritetëve për shpallje.



Takime informuese dhe konsultime publike me OShC-të

31 janar – 20 shkurt 2020



Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), në kuadër të realizimit të misionit të saj dhe në funksion të ofrimit të asistencës financiare për Organizatat e Shoqërisë Civile organizoi në disa qytete të vendit takime informuese dhe konsultimi publik me përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile:

1. Mbi procesin e përzgjedhjes së katër anëtarëve të rinj të shoqërisë civile të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile
2. Mbi procesin e përcaktimit të prioritetëve të Thirrjes nr. 13 për Projekt-Propozime

Për Organizatat e Shoqërisë Civile u krijua gjithashtu mundësia e dërgimit online e komenteve dhe sugjerimeve mbi prioritetet e Thirrjes nr. 13 me e-mail ose në faqen zyrtare www.amshc.gov.al, nga data 28 janar – 20 shkurt 2020.

Takimet u zhvilluan në qytetet: **Vlorë, Korçë, Gjirokastrë, Kukës, Berat, Shkodër dhe Tiranë.**

Në takimet e organizuara si dhe nga shqyrtimi i të gjitha materialeve të marra në rrugë elektronike dhe në formë të shkruar (hard copy), ku përfaqësuesit e OJF-ve dhe grupet e interesit listuan sugjerimet, janë përmbledhur disa prej tyre si më poshtë:

- Dhënie e ndihmës për personat e vetmuar me fokus përballimi i dëmeve të tërmetit të 26 Nëntorit 2019 nga të mbijetuarit kryesisht kryefamiljareve dhe fëmijëve;
- Lufta kundër korrupsionit;
- E drejta e informimit, akses në drejtësi, ndjekja e strategjive për përfshirjen e të rinjëve në qeverisje, transparencë e institucioneve publike;
- Shëndetësia nëpërmjet implementimit të projekteve që ruajnë dhe japin informacione në lidhje me shëndetin fizik dhe mendor, duke u fokusuar tek gratë dhe të rinjtë;
- Nxitja, stimulimi dhe fuqizimi i vullnetarizmit;
- Mbrojtja dhe rehabilitimi i mjedisit; fuqizim i kapaciteteve për parandalimin dhe menaxhimin e situatave të emergjencave natyrore (përmytjet, zjarret, tërmete etj.);

- *Promovimi dhe ruajtja e vlerave historike, etnografike, turistike, artistike, kulturore, guidat turistike, koleksionistët, tolerancës fetare etj. si vlera historike e kombit shqiptar dhe detyrim ndaj brezave të ardhshëm;*
- *Integrimi evropian, integrimi ekonomik rajonal (ballkanik etj.), njohja e standardeve demokratike, diskutimi, debati, dialogu, mendimi ndryshe dhe aftësia për të dëgjuar; zhvillimi i ideve dhe nismave rajonale etj.;*
- *Mirëqeverisja (Pushteti Qendror dhe Lokal), transparenca, llogaridhënia, lufta kundër korrupsionit, përgjegjshmëria dhe integriteti, reforma në drejtësi, rritje kapacitetesh, inovacion, monitorim, partneritet etj.;*
- *Edukim qytetar në funksion të proceseve integruese (familja, shkolla, komuniteti, biznesi, institucionet shtetërore etj.)*



Shpallet thirrja për propozim të kandidatëve për anëtarë të shoqërisë civile në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC)

3 shkurt – 3 mars 2020

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), në rolin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC), shpall thirrjen për propozim të kandidatëve anëtarë të shoqërisë civile në KKShC, për 4 (katër) vendet vakante të krijuara për shkak të përfundimit të mandateve 2-vjeçare, përkatësisht:

- **2 (dy) anëtarë** për fushën e veprimit “A. Demokratizimi, sundimi i ligjit, të drejtat e njeriut dhe integrimi në BE”
- **1 (një) anëtar** për fushën e veprimit “B. Zhvillimi ekonomik-territorialo-mjedisor”
- **1 (një) anëtar** për fushën e veprimit “C. Përmirësimi i mirëqenies, shërbimeve sociale, mbrojtjes së shëndetit si dhe cilësisë së jetës”

FORMULARIN STANDARD TË APLIKIMIT mund ta shkarkoni online në linkun:

<http://www.amshc.gov.al/kkshc/Formular-Aplikimi.pdf>

Në këtë fazë, ftohen të gjitha organizatat e shoqërisë civile të paraqesin propozimet e tyre për kandidatët duke plotësuar **“FORMULARIN STANDARD TË APLIKIMIT”** – Për propozimin e kandidatëve nga përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile në KKShC dhe ta dërgojnë me e-mail në adresën **kkshc@amshc.gov.al**, me referencë të saktë të subjektit: **“Propozim Kandidature për KKSHC”**.

Faza e procesit të Propozimit të Kandidatëve anëtarë të KKShC-së është e hapur **nga data 3 shkurt 2020 deri më 3 mars 2020**, kohë në të cilën paraqiten kandidaturat dhe dokumentacionet mbështetëse si nga ana e organizatave propozuese të kandidatëve, ashtu edhe nga ana e të kandiduarve.

FORMULARI STANDARD I APLIKIMIT dhe gjithë dokumentet mbështetëse të poshtëshënuara duhet t'i dërgoni brenda afatit të përcaktuar, me rrugë elektronike në adresën **kkshc@amshc.gov.al** ose dorazi/me postë në adresën:

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC)
Rruga "Frosina Plaku", Nr. 58, Kati II, Tiranë, Shqipëri

KRITERET PËR KANDIDATËT DHE DOKUMENTACIONET MBËSHTETËSE:

1. Dokumentet që duhen dorëzuar nga organizatat që nominojnë kandidatët:

- Formulari i Aplikimit, i publikuar nga AMSHC
- Kopje e dokumentit të regjistrimit në Gjykatë
- Konfirmim nga zyra e e tatimeve që organizata e ka statusin "aktiv"

2. Kriteret që duhen përmbushur nga kandidatët për KKSHC:

- Të ketë të paktën 3 (tre) vjet eksperiencë në rol drejtues në organizata të shoqërisë civile në fushën ku kandidon
- Të mos ketë role koordinuese ose drejtuese në organizata politike ose parti politike

3. Dokumentet që duhen dorëzuar nga të nominuarit:

- Jetëshkrimi (CV – Curriculum Vitae);
- Letër motivimi nga kandidati për të shpjeguar kontributin që mund të japë pranë KKSHC-së
- Letër konfirmuese nga organizata e shoqërisë civile se kandidati ka të paktën 3 (tre) vite eksperiencë në fushën ku kandidon;
- Pesë letra mbështetëse nga organizata të tjera të cilat mbështesin kandidatin

NOMINIMET DHE PROCEDURA E VOTIMIT:

- Të gjitha Organizatat e Shoqërisë Civile të regjistruara dhe aktive, nominojnë kandidatët e tyre duke pasur parasysh se çdo subjekt **mund të emërojë vetëm një kandidat për anëtar të KKSHC-së.**
- Aplikantëve ju lejohet **një mundësi për të apeluar brenda 3 (tre) ditësh** pas publikimit të listës së nominimeve të vlefshme, në rast se nominimet e tyre janë konsideruar të pavlefshme.
- Komisioni Teknik i AMShC-së pranë KKShC-së publikon në faqen e internetit **Thirrje Publike për Votimin** për kandidatët e vlefshëm. Subjektet votojnë për kandidatët nga lista e kandidatëve të përpiluar nga Komisioni Teknik i AMShC-së **duke respektuar parimin që një organizatë mund të votojë vetëm një herë kandidatin e preferuar për secilën për fushë.**
- Komisioni Teknik i AMShC-së vijon më tej me numërimin e votave (në një seancë të hapur dhe transparente) dhe kandidatët me numrin më të madh të votave të vlefshme, shpallen automatikisht si anëtarë të KKSHC-së

Për më shumë informacione vizitoni faqen www.amshc.gov.al/kkshc, ndërsa për pyetje ju lutemi na shkruani në adresën kkshc@amshc.gov.al.



Java e Integritetit / Forumi Shoqërisë Civile Kundër Korrupsionit

Tiranë, 5 shkurt 2020



Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) mori pjesë në **“Forumin e Shoqërisë Civile Kundër Korrupsionit”**, të organizuar nga Ministria e Drejtësisë, njëherazi dhe Koordinatore Kombëtare Kundër Korrupsionit, i cili u mbajt në ambjentet e Ministrisë së Drejtësisë.



Në fjalën e saj të hapjes, znj. Gjonaj prezantoi draftin e ri të Strategjisë Kundër Korrupsionit për periudhën 2020-2023, ku përfshihet lufta ndaj korrupsionit në administratën publike dhe do të fokusohet te qasja parandaluese, qasja represive e ndëshkuese dhe ajo ndërgjegjësuere.



Përfaqësuesi i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), z. Aga prezantoi shkurtimisht rolin që AMShC-së ka në mbështetjen e nismave të shoqërisë civile në projektet që ndërmarrin në kuadër të antikorrupsionit, transparencës, llogaridhënies dhe integritetit.

Të ftuar të tjerë në forum, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile si dhe ekspertë kundër korrupsionit prezantuan projekte të ndryshme në luftën kundër korrupsionit, pro integritetit, llogaridhënies dhe transparencës.



Ky forum organizohet në kuadër të “Javës së Integritetit”, nismë e cila mundësohet në bashkëpunim me Dhomën Ndërkombëtare të Tregtisë në Shqipëri si dhe mbështetjen e Delegacionit të Bashkimit Evropian dhe Ambasadës Hollandeze në Shqipëri.



Partnerët Shqipëri / Ceremonia e Çmimeve të Filantropisë 2019

Tiranë, 7 shkurt 2020



Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) mori pjesë në ceremoninë e shpalljes së fituesit të konkursit “Çmimi i Filantropisë 2019”, të organizuar nga Partnerët Shqipëri, e cila u mbajt në ambjentet e Hotel Rogner.

Çmimi është mirënjohje ndaj individëve dhe kompanive aktive në mbështetje të kauzave sociale në Shqipëri gjatë vitit 2019.



Pjesëmarrës në ceremoni ishin edhe personalitete nga qeveria shqiptare, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, trupi diplomatik i akredituar në Shqipëri, institucione ndërkombëtare dhe agjenci donatore, përfaqësues të sektorit të biznesit, atij jofitimprurës dhe medias.

Çmimi për Kontributin në Nivel Kombëtar, iu akordua SIGAL UNIQA Group AUSTRIA me motivacion: Për angazhim dhe kontribut të gjerë në shëndetësi, arsim, mjedis, art, sport dhe edukim financiar në fushën e sigurimeve, ku veçohen: Klinika Lëvizëse Mjekësore në shkallë vendi, rikonstruksioni i Shkollës së Mesme të Bashkuar “Matosh UKA” në Fierzë, Tropojë dhe Pallatit të Sportit Përmet, si dhe krijimi i Klubit “Art dhe Kulturë” në dispozicion për të gjithë qytetarët e Durrësit”. Çmimi iu dha z. Avni Ponari, Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA Group Austria, nga znj. Anila Denaj, Ministre e Financave dhe Ekonomisë.

Çmimi për Kontributin në Nivel Lokal iu akordua Kompanisë Mrizi i Zanave, me motivacion: Për kontributin e dhënë në promovimin dhe zhvillimin e vlerave tradicionale të zonës së Fishtës, Lezhë, duke e kthyer atë në një atraksion turistik dhe destinacion kulinar të mbështetur fort në zhvillimin e ekonomisë familjare dhe punësimin e banorëve të zonës. Çmimi iu dha z. Anton Prenga dhe z. Altin Prenga nga z. Silvio Pedrazzi, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Intesa Sanpaolo Bank Albania.

Çmimi për Kontributin si Individ iu akordua Zj. Suela Bala, me motivacion: Për iniciativën e organizimit të “Bibliotekës Lëvizëse”, si një platformë edukuese dhe një dritare integruese për fëmijët dhe të rinjtë nëpërmjet librit në bashkinë e Lezhës, duke krijuar një model të suksesshëm që u shndërrua në një lëvizje gjithëpërfshirëse në të gjithë vendin. Çmimi u dorëzua nga Sh.T. Z. Luigi Soreca, Ambasador i Bashkimit Evropian në Shqipëri.

Çmimi Pionieri i Filantropisë iu akordua z. Hamza Rama (pas vdekjes), me motivacion: Për ndihmën bujare dhe kontributin e çmuar në zbutjen e varfërisë dhe përmirësimin e kushteve shëndetësore të qytetarëve dhe familjeve në nevojë në qytetin e Lezhës dhe fshatrat përreth, si dhe për mbështetjen financiare të klubit sportiv “Bardhyli”, të Lezhës. Çmimi u dorëzua nga znj. Mira Rakacolli, Zv. Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Çmimi u tërhoq nga z. Irfan Rama, i biri i z. Hamza Rama.

Çmimi i Mirënjohjes për Angazhim Qytetar iu akordua zj. Delina Fico, nga zj. Marinela Jazoj, Drejtore Ekzekutive e Shoqatës së Investitorëve të Huaj në Shqipëri dhe Konsulle Nderi e Norvegjisë, me motivacion: Për kontributin e çmuar në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe kauzave të ndryshme sociale në vend, veçanërisht për mbrojtjen e të drejtave të grave e vajzave dhe promovimin e barazisë gjinore në shoqërinë shqiptare.

Çmim Special iu akordua z. Arben Cara me motivacion: Për kryerjen me heroizëm dhe devotshmëri maksimale të detyrës së zjarrfikësit në përpjekjet e kërkim-shpëtimit të jetëve të prekura nga tragjedia e tërmetit të 26 nëntorit 2019, duke vënë në plan të parë misionin e profesionit edhe në kushtet më ekstreme të rrethanave personale.”

Çmim Special iu akordua Komunës së Prizrenit, z. Mytaher Haskuka, Kryetar i Komunës së Prizrenit me motivacion: Për ndihmën bujare dhe të pakushtëzuar në pritjen dhe strehimin e qytetarëve shqiptarë të dëmtuar nga tragjedia e tërmetit të 26 nëntorit 2019, pjesë e mbështetjes dhe solidaritetit të jashtëzakonshëm të popullit dhe institucioneve të Kosovës.

Çmimet Speciale u dorëzuan nga z. Petro Koçi, Zv. Ministër i Mbrojtjes.



Kjo ceremoni ishte planifikuar të zhvillohej në datën 26 nëntor 2019, por për shkak të goditjes së tërmetit u zhvillua më datë 7 shkurt 2020.



AMSHC shpall Thirrjen 13 për projekt-propozime *2 mars – 10 prill 2020*



Thirrja Nr. 13
për projekt-propozime
(2 mars – 10 prill 2020)

The CALL for proposal
(March 2nd – April 10th 2020)

ONLINE:
www.amshc.gov.al

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) shpall Thirrjen Nr. 13 për Shprehje Interesi dhe fton OJF-të e interesuara të sjellin projekt-propozime që kanë si objekt dhe mbulojnë fushën prioritare:

1. Zhvillimi Social dhe Shërbimet Sociale:

- Rritja e kapaciteteve të grupeve, organizatave që kanë si mision të tyre shërbimet sociale;
- Dhënie e ndihmës për personat e vetmuar me fokus përballimi i dëmeve të tërmetit të 26 Nëntorit 2019 nga të mbijetuarit kryesisht kryefamiljareve dhe fëmijëve;
- Rritja e kujdesit për shtresat vulnerabël e ato në nevojë si dhe çështjet e përfaqësimit të minoriteteve (rome, egjiptjan, LGBT, etj);
- Nxitja, stimulimi dhe fuqizimi i vullnetarizmit;
- Shëndetësia nëpërmjet implementimit të projekteve që ruajnë dhe japin informacione në lidhje me shëndetin fizik dhe mendor, duke u fokusuar tek gratë dhe të rinjtë

2. Lufta kundër Korrupsionit dhe Edukimi Ligjor i Publikut:

- Në fushën e Prokurimeve;
- Në fushën e Arsimit;
- Në fushën e Shëndetësisë dhe
- Zbatimit të Ligjit;
- E drejta e informimit, akses në drejtësi, ndjekja e strategjive për përfshirjen e të rinjve në qeverisje, transparencë e institucioneve publike

3. Mjedisi, Turizmi dhe Zhvillimi i qëndrueshëm:

- Mbrojtja dhe rehabilitimi i mjedisit; fuqizim i kapaciteteve për parandalimin dhe menaxhimin e situatave të emergjencave natyrore (përmbytjet, zjarret, tërmete etj.);
- Aktivizmi dhe vullnetarizmi, faktorë të rëndësishëm në mbrojtjen e një mjedisi të shëndetshëm dhe konkurrues i zhvillimit të qëndrueshëm
- Promovimi dhe ruajtja e vlerave historike, etnografike, turistike, artistike, kulturore, guidat turistike, koleksionistët, tolerancës fetare etj. si vlera historike e kombit shqiptar dhe detyrim ndaj brezave të ardhshëm
- Trajnime për mjeshtëri tradicionale që janë në rrezik zhdukjeje (zejtaria, mjeshtër restaurator të shtëpive karakteristike etj.)

4. Integrimi – Shoqëria civile si faktor, aktor dhe partner i rëndësishëm në proceset e integrimit evropian dhe rajonal të vendit:

- Sensibilizim, fuqizim kapacitetesh për një mjedis mundësues në proceset integruese;
- Integrimi evropian, integrimi ekonomik rajonal (ballkanik etj.), njohja e standardeve demokratike, diskutimi, debati, dialogu, mendimi ndryshe dhe aftësia për të dëgjuar; zhvillimi i ideve dhe nismave rajonale etj.;
- Mirëqeverisja (Pushteti Qendror dhe Lokal), transparenca, llogaridhënia, lufta kundër korrupsionit, përgjegjshmëria dhe integriteti, reforma në drejtësi, rritje kapacitetesh, inovacion, monitorim, partneritet etj.;
- Të shihet si prioritet fuqizimi i shoqatave të reja dhe rritja e kapaciteteve të tyre;
- Edukim qytetar në funksion të proceseve integruese (familja, shkolla, komuniteti, biznesi, institucionet shtetërore etj.)

NJOFTIM
për pezullimin e Thirrjes 13

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) në kuadër të masave kundër përhapjes së virusit COVID-19 njofton:

Pezullimin e afatit të aplikimit të organizatave të shoqërisë civile për mbështetje financiare nëpërmjet Thirrjes nr. 13 prej datës 17.03.2020 deri në një njoftim të dytë. Aplikimet e marra me rrugë postare përgjatë kësaj periudhe do të shqyrtohen me mbarimin e afatit të pezullimit.

Për më shumë informacion, vizitoni faqen zyrtare: www.amshc.gov.al



PYETËSOR ONLINE

Për gjendjen e OJF-ve lidhur me situatën e krijuar nga COVID-19

3 – 6 prill 2020

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) realizoi një **PYETËSOR ONLINE** për të kuptuar gjendjen e Organizatave të Shoqërisë Civile lidhur me situatën e krijuar nga COVID-19.

PyetëSORIN e plotësuan 77 Organizata të Shoqërisë Civile, ndërsa shtrirja gjeografike e organizatave (OJF-ve) pjesëmarrëse ishte gjithëpërfshirëse pasi përveç qytetit të Tiranës, i cili ka dhe pjesëmarrjen më të lartë, kanë plotësuar pyetëSORIN dhe organizata në qytete të tilla si Durrës, Korçë, Lushnjë, Fier, Tropojë, Kukës, Përmet, Shkodër, Bulqizë, Librazhd, Pogradec, Gjirokastër dhe Berat.

Lidhur me pyetjen drejtuar kapaciteteve të tyre me Burime Njerëzore, shumica e OJF-ve janë përgjigjur se disponojnë vullnetarë në përbërjen e tyre, ku mesatarisht me kapacitet të plotë disponohet numri prej 5 (pesë) vullnetarësh dhe duke qenë se organizatat pjesëmarrëse janë aktive në organet tatimore ato patjetër disponojnë edhe staf të siguruar. Gjithashtu një pjesë tjetër e organizatave zotërojnë kapacitete të larta me burime njerëzore 10-13 persona, sikundër një pakicë e tyre shprehen se nuk kanë kapacitet në burime njerëzore.

Ndërsa lidhur me kapacitetet në shërbime psiko-sociale rreth 70% e organizatave zotërojnë shërbime të tilla.

Lidhur me target-grupet që kanë pasur në fokus aktivitetet e tyre janë si më poshtë:

- Kategoritë në nevojë (jetimët, nënat kryefamiljare, komuniteti egjiptian, grupet vunerabël);
- Fëmijët me aftësi të kufizuar (Autik dhe Down Syndrome);
- Të rinjtë, adoleshentët;
- Të moshuarit;
- Bizneset Mikro (të vogla dhe të mesme);
- Fermerët;
- Personat me probleme shëndetësore;
- Persona të cilët kanë nevojë për shërbime psikologjike

Në lidhje me kapacitete/mundësi profesionistësh në fushën e rehabilitimit psiko-social, pjesëmarrësit në Pyetësor janë përgjigjur më shumë se mesatarisht se zotërojnë kapacitete të tilla.

Përsa i përket kapaciteteve/mundësive profesionale për shërbime online në fushën e parandalimit dhe rehabilitimit të stresit dhe traumës, rreth 65% e organizatave pjesëmarrëse e ofrojnë këtë shërbim.

Disa nga problematikat që po ndeshin organizatat jofitimprurëse në situatën e krijuar nga COVID-19 janë të listuara si më poshtë:

- Probleme financiare dhe pezullim projektesh (Shlyerje detyrimesh të tilla si qera ambjentesh, pagesë sigurimesh, tatimesh si dhe shpenzimeve të tjera operative);
- Adresimi i nevojave të njerëzve që nuk dëgjojnë për arsye të mungesës së aksesit në gjuhën e shenjave shqipe;
- Bllokimi i financimeve nga donatorët si pasojë e situatës;
- Mungesë të kryerjes së aktiviteteve në terren dhe ndërpevritimit me target-grupet e synuara, si rezultat i masave të marra;
- Për ato OJF me profil shëndetësor vihet re mungesa e kompensimit të pagave për stafin mjekësor (mjekë, infermierë, fizioterapistë, etj.)

Zgjidhjet e propozuara lidhur me problematikat e hasura janë:

- Mbështetje financiare;
- Konsultim nga specialistët e AMShC-së për riplanifikimin e aktiviteteve;
- Ngritjen e shërbimit të interpretimit në gjuhën e shenjave shqipe;
- Përshtatje të projektit dhe aktiviteteve për periudhën e mbetur;
- Komunikim online me video call ose video konferenca dhe përdorimi i medias tradicionale dhe sociale;
- Subvencionim të pagave për stafin e siguruar, për periudhën Prill – Qershor 2020;
- Krijimin dhe funksionimin e rrjetit dhe jo të mbivendosjes së shërbimeve;
- Të ofrohet pagesa nga ana e qeverisë për punonjësit e siguruar të OJF-ve si dhe kompesim për pagesën e qerave dhe shpenzimeve operative;
- Trajnime, workshope si dhe ofrim konsulencash online

Listimi i kontributeve që OJF-të pjesëmarrëse në Pyëtesor mund të jepen lidhur me situatën e COVID-19 është si më poshtë:

- Këshillim dhe terapi psikologjike online;
- Vënia në dispozicion e ambjenteve që organizata jofitmirurëse disponojnë;
- Edukim dhe ndërgjegjësim të komunitetit në përgjithësi dhe grupeve të caktuara në veçanti mbi përballimin e situatës.
- Ofrim shërbimesh me vullnetarë në raste të veçanta sidomos për të sëmurët dhe të moshuarit;
- Shërbime online për personat me aftësi të kufizuara;
- Ekspertizë në nivel IT, Menaxhim burimesh njerezore;
- Shërbimeve psiko-sociale dhe juridike online;
- Asistencë humanitare për shpërndarjen e pakove ushqimore pranë familjeve në nevojë;
- Trajtime online të personelit shëndetësor lidhur me situatën e COVID-19;
- Vënia në dispozicion e bimëve mjeksore;
- Sensibilizim i qytetarëve mbi situatën dhe masat e higjienës personale;
- Ofrimi i shërbimeve të mjekësisë së familjes si dhe të shërbimit të Telemedicinës online

Përsa i takon mundësive për zhvillimin e aktiviteteve në kushtet e shkaktuara nga COVID-19, Organizatat veprojnë si më poshtë:

- Trajtime, workshope, konsulta dhe seminare online;
- Shërbim pranë familjeve në nevojë si dhe të moshuarve;
- Mbështetje psikologjike, sensibilizuese dhe mjeksore nëpërmjet platformave online;
- Transformimi i aktiviteteve për t'i përshtatur online komunitetit që i ofrohen;
- Duke punuar brenda fashave orare të vendosura nga qeveria duke ruajtur dhe masat e distancimit social



NJOFTIM

Pezullohet procesi i zgjedhjeve për katër anëtarët e shoqërisë civile në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC)

Tiranë, 3 prill 2020

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), në rolin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC), ju njofton se për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19 pezullohet procesi i zgjedhjeve për katër kandidatët anëtarë të shoqërisë civile në KKShC deri në një njoftim të dytë.



PYETËSOR ONLINE



Lidhur me OJF-të dhe drejtësinë e Gjykatës së Tiranës

Projekt i financuar
nga Bashkimi Evropian



6 – 20 maj 2020

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) ftoi Organizatat e Shoqërisë Civile think-tank të plotësojnë një **PYETËSOR ONLINE lidhur me OJF-të dhe drejtësinë e Gjykatës së Tiranës**, e cila është përgjegjëse për regjistrimin e këtyre OJF-ve.

Ky pyetësor online, i financuar nga BE, është parashikuar të përgatitet brenda Kornizës së Projektit, me Nr. 2019/413554 për *“Mbështetjen e zbatimit të një Udhërrëfyesi në Politikën Qeveritare, i cili do të mundësojë një mjedis të favorshëm për zhvillimin e Shoqërisë Civile”*.

Qëllimi i këtij pyetësori është që të ndihmojë projektin të përcaktojë nëse ka nevojë për përmirësime të mëtejshme të kornizës ligjore dhe/ose praktikave që lidhen me regjistrimin e organizatave jofitimprurëse – OJF-ve (shoqatat, fondacionet dhe qendrat) në Shqipëri.



PYETËSOR ONLINE për fazën e parë të konsultimeve me OShC-të
mbi përmirësimin e procesit të monitorimit dhe raportimit të Udhërrëfyesit dhe zhvillimin e strategjisë së komunikimit për AMShC-në dhe Udhërrëfyesin

Projekt i financuar
nga Bashkimi Evropian



21 maj – 8 qershor 2020

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) ftoi Organizatat e Shoqërisë Civile të plotësojnë një **PYETËSOR ONLINE lidhur me Udhërrëfyesin për politikën e qeverisë drejt një mjedisi më mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile**.

PYETËSOR ONLINE për fazën e parë të konsultimeve me OShC-të mbi përmirësimin e procesit të monitorimit dhe raportimit të Udhërrëfyesit dhe zhvillimin e strategjisë së komunikimit për AMShC-në dhe Udhërrëfyesin.



LETËR E HAPUR
Kërkesë për fillimin e lejimit të aktiviteteve të OShC-ve
Tiranë, 5 qershor 2020

Anëtarë dhe ish anëtarë përfaqësues nga organizata të shoqërisë civile në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC) më datë 05.06.2020 përpiluan një letër, ku kërkojnë fillimin e lejimit të aktiviteteve të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC), të cilën ia drejtuan:

1. Zj. Ogerta Manastirliu

Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Kryetare e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC)

2. Komitetit Teknik të Ekspertëve (për masat kundër COVID-19)

E nderuar Zj. Ogerta Manastirliu,

Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe

Kryetare e KKSHC – Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile

Ne, anëtarët e shoqërisë civile në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile dhe ish anëtarë në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile me anë të kësaj kërkesë do të deshëm të kërkojmë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Komitetit Teknik të Ekspertëve (për masat Anti COVID-19) të konsiderojë të hapë ose të përcaktojë se kur aktivitetet që lidhen me organizimin e aktiviteteve të organizatave të shoqërisë civile në terren, pasi në urdhëresën e fundit nr **351** datë 29/05/2020 shumë aktivitete të ngjashme janë hapur, ndërkohë që është e paqartë për organizatat që ofrojnë shërbime dhe aktivitete të tjera që lidhen me vijimin e aktiviteteve të shtyra në kohë nga komuniteti ynë.

Aktualisht: janë hapur palestarat, qendrat e formimit profesional, qendrat e edukimit, qendrat e internetit (pika 6 e urdhrit 351, etj.)

Situata e hapjes për aktivitete që përshkruam të cilat kanë fushë veprimi të ndryshme, por kanë objekt aktiviteti të njëjtë me mënyrën e zhvillimit dhe përdorimit të ambienteve të mbyllura ose të hapura na bën të besojmë se ka ardhur momenti që jemi në kushtet kur edhe aktivitetet tona duhet të rifillojnë dhe t'i kthehen një "normaliteti" pune pasi mungesa e aktivitetit zhvillues është një element i cili po e rruddh rolin që kanë OSHC-të.

Organizatave të Shoqërisë Civile nuk u përfshinë nga paketat ekonomike edhe se shumë aktivitete të OSHC-ve ende vijnë të mbyllura si pasojë e ndërprerjes së aktiviteteve normale, ndaj do të deshëm që aktivitetet duhet të rifillojnë pa humbur kohë dhe me një urdhër sa më të afërt.

Një pjesë e mirë e punës së organizatave të shoqërisë civile është e lidhur ngushtë nëpërmjet workshop-ve, seminareve, konferencave apo edhe aktiviteteve edukuese etj.

Vijimi i mbajtjes mbyllur po e pengon punën e organizatave të shoqërisë civile që edhe nga paketat ekonomike nuk përfituan pasi u konsideruan në kushtet që mund të vijonin punën edhe në kushtet e pandemisë COVID-19.

Në këtë funksion ne do të deshëm që aktivitetet, takimet, seminarët të fillojnë të zhvillohen me kapacitete të reduktura në pjesëmarrje, duke zbatuar protokolle të qarta të distancimit fizik dhe social si dhe garancitë që sallat do të respektojnë protokollet e miratura në rast se aktivitetet do të mbahen në ambiente të mbyllura.

Sa më sipër

Kërkojmë një përgjigje zyrtare

- Me sa njerëz mund të bëjmë aktivitetet, në çfarë ambientesh dhe si mund t'i përdorim ato dhe masat që duhen marrë.
- Marrja e lejes për rifillimin e aktiviteteve si është parashkuar të ndodhë: nga e-Albania.al apo në një formë tjetër.
- Specifikimin në urdhrin e radhës të aktiviteteve që lidhen me organizatat e shoqërisë civile të rifillojnë aktivitetin e tyre.

Për sa më sipër ne kërkojmë shqyrtimin e kësaj kërkesë në mbledhjen e parë të afërt të Komitetit Teknik të Ekspertëve (për masat Anti COVID-19) në lidhje me fillimin e hapjes dhe zhvillimit të aktiviteteve brenda dhe jashtë (*in door* dhe *outdoor*).

Ne jemi të hapur të konsiderojmë çdo takim të mundshëm në funksion të këtyre zhvillimeve *online* apo të parashkuara nga ju.

Gjithashtu me anë të kësaj letre ne do deshëm gjithashtu t'ju falënderojmë për punën e madhe dhe të palodhur që keni patur dhe vazhdoni të keni në interes të shëndetit publik.

Me respekt

Anëtarët dhe ish anëtarë të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile:

Vladimir **THANO**, Iris **LUARASI**, Fabiola Laço **EGRO**, Ergys **GEZKA**, Blendi **DIBRA**, Indrit **SEFERI**, Zana **VOKOPOLA**, Arta **DYRMISHI**, Mirela **KOÇI**

Takim të përbashkët online mbi “Menaxhimin e Mbetjeve Plastike”

Tiranë, 8 qershor 2020

Kontrolli i Lartë i Shtetit, me ndërmjetësimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) zhvilloi një takim informues online me OJF-të që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e Mbrojtjes së Mjedisit dhe/ose Menaxhimit të Mbetjeve në tërësi (*ku mbetjet plastike janë një nga rrymat e mbetjeve*) apo Mbetjeve Plastike në veçanti.

Ky takim u zhvillua në kuadër të zbatimit të Planit Vjetor të Auditimeve nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSh), për Auditimin e Performancës me temë “Menaxhimi i Mbetjeve Plastike”, i cili shtrihej në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe bashkitë Tiranë, Elbasan dhe Vlorë.

LETËR E HAPUR

Për një sistem zgjedhor, i cili përfaqëson më të mirën për qytetarët shqiptar

Tiranë, 10 qershor 2020

Organizatave përfaqësuese nga shoqëria civile në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile dhe rrjeti i organizatave, më datë 10.06.2020 i drejtojnë këtë letër të hapur:

- **Qytetarëve të Republikës së Shqipërisë**
- **Partive politike në Shqipëri**
- **Partnerëve ndërkombëtarë**

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Duke marrë shkas nga arritja së fundmi e marrëveshjes politike për reformën zgjedhore, ne mendojmë se nëpërmjet kësaj marrëveshjeje nuk ka përmirësim të qenësishëm që të mundësojë rritjen e nivelit të përfaqësimit të popullit shqiptar; përveç liderëve kryesorë politikë, edhe me këtë marrëveshje, populli shqiptar nuk ka mundësinë të zgjedhë përfaqësuesit e vet, por do të informohet për ta vetëm pas përfundimit të procesit zgjedhor.

Të gjithë jemi të vetëdijshëm që, prej më shumë se dy dekadash, niveli i debatit në Parlament sa vjen e bëhet më i dobët dhe besimi tek sistemi aktual i zgjedhjeve ka rënë, siç e vërtetojnë anketimet e shumta me qytetarët, duke bërë tepër të nevojshme një reformë zgjedhore më të thellë, e cila të garantonte një proces më të drejtë përfaqësimi.

Ne jemi të mendimit se, në të kundërt me nevojën, marrëveshja e arritur është një konsolidim i sistemit aktual të ndërtuar mbi Me respekt,

Organizatave përfaqësuese nga shoqëria civile në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile dhe rrjeti i organizatave

konsensusin jo transparent të dy palëve politike, dhe nuk përbën një hap përpara në përfaqësimin e dëshiruar demokratik.

Zonja dhe zotërinj,

Shoqëria civile shqiptare, edhe pse e fragmentuar dhe e ekspozuar ndaj varësisë nga politika, ndjen domosdoshmërinë të reagojë ndaj marrëveshjes së arritur nga liderët politikë, e cila nuk përbën suksesin e publikuar nëpërmjet mediave.

Thirrjet e herëpashershme të shoqërisë dhe qeverisë shqiptare, dhe së fundmi, të vetë komunitetit ndërkombëtar, që shoqëria civile të dëgjohet, vitet e fundit nuk janë marrë parasysh, aq më pak në “reformën zgjedhore”.

Nëpërmjet kësaj letre publike i bëjmë thirrje përfaqësuesve politikë që të rishikojnë qëndrimin e tyre dhe të kontribuojnë më mirë për të vendosur një sistem zgjedhor, i cili përfaqëson më të mirën për qytetarët shqiptar.



AMSHC shpall Thirrjen 13 (të vogël) për projekt-propozime

22 qershor – 23 korrik 2020



Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) në vijim të Vendimit të Bordit Mbikqyrës të AMShC-së njofton anulimin e Thirrjes 13 të pezulluar për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19 si dhe buxhetit të reduktuar në mbështetje të akteve normative për këtë situatë.

Në këtë kuadër, AMSHC njofton shpalljen e Thirrjes 13 (të vogël)^{iv} 22 qershor – 23 korrik 2020.

Ftohen OJF-të e interesuara të sjellin projekt-propozime që kanë si objekt dhe mbulojnë fusha të kësaj Thirrje të vogël, të fokusuara tek emergjenca e krijuar nga pandemia e COVID-19:

1. Shëndetësia dhe telemjekësia (MED) si mundësi për monitorimin e pacientëve duke ju përshtatur kushteve shkaktuar nga COVID-19, në distancë si dhe ofrimin e shërbimeve të mjekësisë në familje ONLINE;
2. Shërbime psikosociale për situatën e post-COVID-19 për grupet në nevojë (të moshuarit, PAK, fëmijët PAK etj), përfshirë këshillim dhe terapi psikologjike, si edhe shërbime juridike, online;
3. Trajnime online të personelit shëndetësor lidhur me situatën e COVID-19;
4. Iniciativa të tjera inovative për të përmirësuar situatën e krijuar nga COVID-19;
5. Nxitja, stimulimi dhe fuqizimi i vullnetarizmit;
6. Mbështetje psikologjike, sensibilizuese dhe mjekësore nëpërmjet platformave të ndryshme

Për informacion të plotë rreth Thirrjes, ju lutemi vizitoni faqen zyrtare web: www.amshc.gov.al



Takim i anëtarë përfaqësues të shoqërisë civile në Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC)

Tiranë, 2 korrik 2020

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) në kuadër të konsultimit publik të draftit të Projektligjit “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”, i cili synon minimizim e procesit të regjistrimit të OJF-ve por edhe sigurimin e transparencës lidhur me funksionimin e tyre, organizoi mbajtjen e një takimi online me anëtarë përfaqësues të shoqërisë civile në KKShC, ditën e enjte, datë 2.7.2020, ora 10:30 nëpërmjet platformës / aplikacionit ZOOM.

^{iv} Thirrja 13 (e vogël) shpallet për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19 dhe me buxhet të reduktuar në zbatim të Aktit Normativ Nr. 6, datë 21.3.2020 “Për buxhetin e vitit 2020”.

**KONSULTIM PUBLIK ONLINE
me organizata të shoqërisë civile**

Projektligji “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”

6 – 9 korrik 2020

Ministria e Drejtësisë si institucioni përgjegjës në grupin ndërinstitutional të punës ka hartuar Projektligjin “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”, i cili synon minimizim të procesit të regjistrimit të organizatave jofitimprurëse por edhe sigurimin e transparencës lidhur me funksionimin e tyre, veprimtarinë dhe objektin e tyre.

Në kuadër të konsultimit publik të këtij projektligji si dhe në vijim të konsultimeve të ndërmarra nga Ministria e Drejtësisë edhe nëpërmjet linkut⁹ të Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) dhe anëtarë të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile ftuan përfaqësues të shoqërisë civile nga të gjitha qarqet e vendit të merrnin pjesë në konsultime publike online, të cilat u organizuan sipas kalendarit të mëposhtëm:

Datë: 6 korrik 2020

Ora: 11:00

Të ftuar: Përfaqësues nga qarku Shkodër, Kukës, Lezhë

Datë: 7 korrik 2020

Ora: 11:00

Të ftuar: Përfaqësues nga qarku Tiranë, Durrës, Dibër

Datë: 8 korrik 2020

Ora: 11:00

Të ftuar: Përfaqësues nga qarku Elbasan, Fier, Berat

Datë: 9 korrik 2020

Ora: 11:00

Të ftuar: Përfaqësues nga qarku Korçë, Gjirokastër, Vlorë



⁹ <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/272>

Shpallet lista emërore e kandidaturave nga shoqëria civile të kualifikuara për t'u votuar
Tiranë, 14 korrik 2020

amshc
Agjencia për Mbështetjen
e Shoqërisë Civile

**KËSHILLI KOMBËTAR
PËR SHOQËRINË CIVILE**

PROCES I ZGJEDHJEVE

për katër anëtarë të rinj nga shoqëria civile për
Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile

Vakancë e krijuar për shkak të përfundimit të mandateve:

- **2 (dy) anëtarë** – Fusha e veprimit A.
- **1 (një) anëtar** – Fusha e veprimit B.
- **1 (një) anëtar** – Fusha e veprimit C.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit për paraqitur nga kandidatët, Komisioni Teknik i Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile shpall listën emërore të kandidatëve të kualifikuar për t'u votuar për:

- dy anëtarë për fushën e veprimit A.
- një anëtar për fushën e veprimit B.
- një anëtar për fushën e veprimit C.

Lista emërore e kandidatëve

Fusha e veprimit A.

“Demokratizimi, sundimi i ligjit, të drejtat e njeriut dhe integrimi në BE”

- 1. Armando Bala**
- 2. Arta Dyrmishi**
- 3. Dritan Sakuta**
- 4. Florian Trojani**

Fusha e veprimit B.

“Zhvillimi ekonomik-territorialo-mjedisor”

- 1. Ermelinda Mahmutaj**
- 2. Rendi Myslimaj**

Fusha e veprimit C.

“Përmirësimi i mirëqenies, shërbimeve sociale, mbrojtjes së shëndetit si dhe cilësisë së jetës”

- 1. Andi Rabiaj**
- 2. Irena Laska**
- 3. Majlinda Driza**



Ngushëllime për ndarjen nga jeta të z. Ali Coka

Tiranë, 18 korrik 2020



Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile dhe Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile

Me hidherim të thellë mësuam lajmin për ndarjen nga jeta të anëtarit të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile z. Ali Coka pas një beteje të gjatë me sëmundjen.

Z. Ali Coka punoi me vendosmëri dhe këmbëngulje deri në fund për çështje të rëndësishme për Shoqërinë Civile duke mbuluar me dinjitet dhe optimizëm çështje të mjedisit në Shqipëri.

Kjo mbetet një humbje e madhe për Shoqërinë Civile në vend, për KKShC-në si dhe për shoqërinë tonë të cilës do t'i mungojë një zë i fortë i kritikës konstruktive, përfaqësues i denjë i shqetësimeve qytetare, i cili me optimizmin dhe këmbënguljen e tij ka qenë një figurë e spikatur e fushës.

KKShC dhe AMShC i shprehin familjes së të ndjerit Coka ngushëllimet më të sinqerta.



Mbledhja e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC)

Tiranë, 21 korrik 2020



Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) në rolin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC) në kuadër të konsultimit publik të draftit të Projektligjit “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”, organizoi mbajtjen e mbledhjes online të KKShC-së, ditën e martë, datë 21.7.2020, ora 15:00 nëpërmjet platformës / aplikacionit ZOOM.



Mbledhja u drejtua nga Kryetarja e KKShC-së, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, znj. Ogerta Manastirliu.

Në fillim të fjalës së saj, znj. Manastirliu falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen si dhe në emër të Këshillit shprehu ngushëllimet e sinqerta për humbjen e parakohshme të jetës së anëtarit të shoqërisë civile pranë Këshillit, z. Ali Coka.

Në vijim të agjendës së mbledhjes u zhvillua prezantimi i projektligjit për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse nga z. Besmir Beja si dhe diskutime me të pranishmit për këtë projektligj.



VOTIM ONLINE
Për zgjedhjen e katër anëtarëve në KKShC
15 – 22 korrik 2020

Në vijim të procesit të zgjedhjeve për katër anëtarë përfaqësues të shoqërisë civile në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC), vakanca të krijuara për shkak të përfundimit të mandateve 2-vjeçare, Komisioni Teknik i AMShC-së realizoi procesin e VOTIMIT ONLINE për periudhën 8-ditore nga data 15 – 22 korrik 2020, i aksesueshëm në linkun: www.amshc.gov.al/kkshc



Shpallen emrat e katër anëtarëve të rinj nga shoqëria civile
në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile
Tiranë, 8 shtator 2020

Pas përfundimit të fazës së numërimit dhe rikonfirmimit të votës online, në kuadër të zgjedhjeve për katër vendet vakante të anëtarëve përfaqësues të shoqërisë civile në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC), të krijuara për shkak të përfundimit të mandateve 2-vjeçare, Komisioni Teknik i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) pranë KKShC-së shpalli emrat e katër anëtarëve të rinj të zgjedhur nga procesi i votimit:

- **Për fushën e veprimit A.**

“Demokratizimi, sundimi i ligjit, të drejtat e njeriut dhe integrimi në BE”

- 1. Dritan Sakuta**

Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim (RIAS)

- 2. Armando Bala**

Vizioni i Ri 2016 / New Vision Organization

- **Për fushën e veprimit B.**
“Zhvillimi ekonomiko-territorialo-mjedisor”
1. Ermelinda Mahmutaj
Qendra Mjedisore për Zhvillim, Edukim dhe Rrjetëzim (EDEN)
- **Për fushën e veprimit C.**
“Përmirësimi i mirëqenies, shërbimeve sociale, mbrojtjes së shëndetit si dhe cilësisë së jetës”
1. Andi Rabiaj
Rrjeti i Organizatave “Zëri i të Rinjve”

Gjithashtu, Komisioni Teknik i AMShC-së pranë KKShC-së bëri shpalljen dhe publikimin online të “Tabelës përmbledhëse të rezultateve përfundimtare të votimit online për katër anëtarë nga shoqëria civile në KKShC” dhe “Listat emërore të kandidatëve të votuar online me rezultatet përfundimtare të votimit për katër anëtarë nga shoqëria civile në KKShC”.

Për më shumë informacion, vizitoni linkun:
www.amshc.gov.al/kkshc



LETËR E HAPUR

Për të drejtën e protestës në kohë pandemie

Tiranë, 5 nëntor 2020



Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) mori pjesë në një aktivitet të organizuar nga organizata “Qëndresa Qytetare”, “Qendra për të Drejtat në Punë CLR” dhe “Qendra Olof Palme” lidhur me të drejtën e protestës në kohë pandemie, ku të ftuar të tjerë kishte aktorë të shoqërisë civile, sindikatave të pavarura, përfaqësues të institucioneve të pavarura dhe aktivistë.

Përfaqësues të shoqërisë civile, institucioneve të pavarura dhe aktivistë kërkojnë që t'u rikthehet e drejta e tubimit dhe protestës - e cila është kufizuar si pjesë masave të distancimit social për parandalimin e pandemisë së COVID-19.

Institucioni i Avokatit të Popullit, përfaqësuar nga znj. Erinda Ballanca, adresoi këtë situatë të krijuar në vend duke kontribuar me analizën dhe rekomandimet drejtuar institucioneve shqiptare, për të mos ndaluar të drejtën e qytetarëve të protestojnë.

E ftuar në aktivitet gjithashtu edhe Ambasadorja e Suedisë në Tiranë, znj. Elsa Hastad i vlerësoi si shumë të rëndësishme protestat në shoqëri demokratike edhe në situatë pandemie.

Protesta, ashtu si në të gjitha vendet e zhvilluara të cilat në shumicën e rasteve kanë një situatë më të rënduar të pandemisë, nuk e kanë mohuar të drejtën e protestës, por kanë vendosur protokolle për të parandaluar përhapjen e infeksionit Covid 19.

Nisur nga situata e mohimit të protestave qytetare në Shqipëri prej datës 15 Mars 2020, së bashku Organizata të Shoqërisë Civile dhe sindikata të pavarura i drejtuan një Letër të Hapur institucioneve më të larta të vendit për të kërkuar:



- Një protokoll Anti-Covid për organizimin e protestave qytetare, ashtu si protokollet për baret, kafet, kinematë e pishinat
- Rishikimin e masave ligjore në lidhje me të drejtën e tubimit
- Ndërprerjen e menjëhershme të praktikës së deritanishme të Policisë së Shtetit për moslejimin e tubimeve në ambiente të hapura nga ana e qytetarëve



**Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) prezanton
Indeksin e Qëndrueshmërisë së OShC-ve:
Raporti për Shqipërinë 2019
Tiranë, 19 nëntor 2020**



Përfaqësuese nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) mori pjesë në takimin prezantues të **“Indeksi i Qëndrueshmërisë së OShC-ve (CSOSI): Raporti për Shqipërinë 2019”**, të organizuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), i cili u zhvillua online nëpërmjet platformës ZOOM.

CSOSI 2019 për Shqipërinë është pjesë e edicionit të 23-të të CSOSI për Evropën Qendrore dhe Lindore dhe Euroazinë duke monitoruar aspektet kryesore të qëndrueshmërisë në sektorin e OShC-ve. Gati 35 pjesëmarrës nga shoqëria civile, komuniteti i donatorëve, institucionet publike dhe përfaqësuesit e mediave u bashkuan me takimin dhe diskutuan trendet e qëndrueshmërisë në sektorin e OShC-ve.



Autorët e raportit prezantuan gjetjet kryesore për Shqipërinë duke nënvizuar se qëndrueshmëria e përgjithshme e sektorit të shoqërisë civile shqiptare nuk ndryshoi në vitin 2019, megjithëse u bënë përmirësime të vogla në disa dimensione të qëndrueshmërisë së OSHC-ve.

Gjetjet kryesore të raportit përfshijnë:

- Kapaciteti organizativ u përmirësua pak në 2019 si rezultat i programeve të donatorëve të përqendruar në ndërtimin e kapaciteteve gjatë viteve të fundit,
- Fillimi i Qendrës Kombëtare të Burimeve për Shoqërinë Civile në Shqipëri rriti infrastrukturën sektoriale.
- Sigurimi i shërbimeve u përmirësua pak në 2019, pasi OShC-të u mobilizuan shpejt për të përmbushur nevojat e popullatave të prekura nga tërmeti në nëntor;
- OShC-të vazhduan të shfaqnin një avokim të fortë, ndërsa ato u angazhuan në mënyrë aktive në iniciativa të rëndësishme dhe demonstuan këmbëngulje në ndjekjen e misioneve të tyre.
- Qëndrueshmëria financiare vazhdon të jetë dimension i më i dobët i qëndrueshmërisë. Ky dimension vazhdoi të shënohej nga mungesa e fondeve, veçanërisht për OShC-të më të vogla dhe mungesa e larmisë në modalitetet e financimit.
- Të dy dimensionet: korniza ligjore dhe imazhi publik ishin të qëndrueshme në 2019.


Përfaqësuesja e USAID në Shqipëri, znj. Zhaneta Shatri në fjalën e saj përshëndetëse nënvizoi rolin jetësor të OShC-ve në Shqipëri të demonstruar në reagimin e menjëhershëm ndaj popullsisë së prekur nga tërmeti dhe mobilizimin e tyre gjatë pandemisë Covid-19.

Anëtarët e panelit të ftuar nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), Partnerët Shqipëri, Qendra Kombëtare e Burimeve për OShC-të, World Vision Albania, Eco Albania, BIRN etj., ndanë perspektivat e tyre mbi trendet në sektor dhe zhvillimin kryesor që ndikojnë në qëndrueshmërinë e OSHC-ve.

Prezantimet e tyre, duke u përqendruar në sfidat dhe pengesat për qëndrueshmërinë e OSHC-ve si dhe historitë e suksesit, krijuan interesin e pjesëmarrësve për dimensionet e ndryshme të qëndrueshmërisë së OSHC-ve. Gjithashtu ata ofruan njohuri shumë të dobishme mbi dinamikën dhe zhvillimin e fundit në sektorin e OShC-ve, të cilat duhet të merren parasysh gjatë procesit të përgatitjes së raportit CSOSI për vitin 2020.

Klikoni lidhjen e mëposhtme për të shkarkuar **Raportin CSOSI 2019 & Fletën e Fakteve** në Shqip dhe Anglisht: <https://idmalbania.org/csosi-usaid-report-for-albania>

Mbledhja e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC) Tiranë, 26 nëntor 2020



Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) në rolin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC) organizoi mbajtjen online të mbledhjes së KKShC-së, ditën e enjte, datë 26.11.2020, ora 11:00 nëpërmjet platformës / aplikacionit ZOOM.



Mbledhja u drejtua nga Zëvendësministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, z. Albert Nikolla.

Gjatë mbledhjes u prezantuan katër anëtarët e rinj të zgjedhur nga shoqëria civile si dhe u vijua me prezantimin për konsultimin e Planit të Veprimit të Open Government Partnership (OGP); prezantimin për mbështetjen e zbatimit të Udhërrëfyesit (Road Map) të Shoqërisë Civile; etj.

